

BALKANS ACT NOW!

STUDIM KRAHASUES MBI RAPORTERËT KOMBËTARË PËR TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE DHE MEKANIZMAT EKVIVALENTË

Marjan Wijers
Nëntor 2018



Projekti Balkans ACT (Kundër Krimin të Trafikimit) Now!
Financohet nga Instrumenti i Bashkimit Evropian për Ndhmën Para-Aderuese (IPA) për Konsolidimin e Rrjeteve Rajonale Tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile
Call ID: EuropeAid/154870/DH/ACT/Multi; Nr. i Kontratës: 2017/394-348

Përktheu nga gjuha angleze Krisi Anastas

Përmbajtja e Lëndës

1. Hyrje	1
2. Vështrim i përgjithshëm mbi Raportet Kombëtarë ose mekanizmat ekuivalent në vendet anëtare të BE-së	2
3. Holanda	9
4. Finlanda	14
5. Belgjika	21
6. Portugalia	25
7. Konkluzione dhe Rekomandime	29
Bibliografia	33

1. Hyrje

Sipas Direktivës së BE-së (2011) mbi Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore¹, shtetet anëtare janë të detyruara të krijojnë një Raporter Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore ose një mekanizëm ekuivalent. Më saktësisht, Neni 19 shprehet:

Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të krijuar Raporterë kombëtarë ose mekanizma ekuivalentë. Detyrat e mekanizmave të tillë përfshijnë raportimin, vlerësimin e tendencave të trafikimit të qenieve njerëzore, matjen e rezultateve të masave kundër trafikimit, përfshirë mbledhjen e statistikave në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile që janë aktive në këtë fushë.

Themelet e këtij neni u hodhën nga Deklarata Ministrore e Hagës mbi udhëzimet evropiane për masa efektive mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të grave për shfrytëzim seksual. Ajo u miratua në vitin 1997 pas një konference ministrore për trafikimin e grave të organizuar nga Holanda në kuadër të BE-së. Një nga rekomandimet e Deklaratës ishte si vijon:

Shtetet Anëtare duhet të,

- Sigurojnë ose kërkojnë mundësi për emërimin e raporterëve kombëtarë, të cilët raportojnë tek qeveritë mbi shkallën, parandalimin dhe luftimin e trafikimit të grave.
- Hartojnë kritere për raportimin mbi shkallën, natyrën dhe mekanizmat e trafikimit të grave dhe efektivitetin e politikave dhe masave në lidhje me këtë fenomen.
- Inkurajojnë rregullisht bashkëpunimin e raporterëve kombëtarë.

Nevoja për të dhëna të besueshme dhe bashkëpunim reflektohet në Përfundimet e Këshillit Evropian të Qershorit 2009², i cili themeloi një Rrjet joformal të raporterëve dhe/ose mekanizmave ekuivalentë. Qëllimi i Rrjetit është të përmirësojë të kuptuarit e fenomenit të trafikimit, si dhe t'i sigurojë BE-së dhe vendeve anëtare informacion strategjik objektiv, të besueshëm, të krahasueshëm dhe të përditësuar. Rrjeti mbledhet dy herë në vit nën koordinimin e Komisionit Evropian për të diskutuar zhvillimet e fundit në fushën e luftës kundër trafikimit. Institucionet e BE-së dhe institucionet e tjera ndërkombëtare ftohen të marrin pjesë në rrjet si vëzhgues. Rrjeti duhet t'i sigurojë Unionit dhe Shteteve Anëtare informacion strategjik objektiv, të besueshëm, të krahasueshëm dhe të azhurnuar në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

¹ Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Prillit 2011 mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij.

² Konkluzione të Këshillit për krijimin e një Rrjeti Informal të Raporterëve Kombëtarë të BE-së ose Mekanizmave Ekuivalentë mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Takimi i 2946 i Këshillit të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme Luksemburg, 4 qershor 2009.

Për një kohë të gjatë, Holanda ishte një nga vendet e pakta që emëruan një reporter të vërtetë kombëtar. Nga viti 2011 pothuajse të gjitha vendet anëtare të BE-së krijuan një të tillë, megjithëse shumica e tyre zgjodhën një mekanizëm ekuivalent me Reporterin.

Ky raport diskuton mbi modelet e ndryshme të Reporterit Kombëtar për trafikimin e qenieve njerëzore ose mekanizmave ekuivalente në vendet anëtare të BE-së. Studimi u krye në kuadër të fazës së tretë të projektit të financuar nga KE, *Balkans Act Now!* Një nga qëllimet e projektit është të promovojë monitorimin sistematik të politikave antitrafik përmes krijimit të një Reporterit Kombëtar.

Raporti fillon me një përmbledhje të shkurtër të mënyrave se si shtetet anëtare të BE-së kanë organizuar institucionin e Reporterit Kombëtar ose mekanizmin ekuivalent. Më tej, ai shqyrton nga afër modelet e katër vendeve: Holanda, Finlanda, Belgjika dhe Portugalia. Këto katër vende u zgjodhën për arsye parimore dhe praktike. Të gjitha pranojnë vlerën e një Reporterit Kombëtar (ose një mekanizmi ekuivalent), por zgjodhën një model të ndryshëm. Të katërta shtetet kanë përvojë të konsiderueshme me institucionin e Reporterit kombëtar. Nga ana praktike, u bë e mundur të organizohej një intervistë me zyrën e Reporterit Kombëtar në këto vende, qoftë ballë për ballë, ashtu edhe përmes Skype. Për më tepër, informacionet për punën e Reporterit ishin të disponueshme në gjuhën angleze dhe lehtësisht të arritshme.

Raporti përfundon me një seri konkluzionesh dhe rekomandimesh, bazuar në intervistat me Reporterët e vendeve të përmendura. Të katër reporterët u pyetën se çfarë shohin si vlerë të shtuar të një Reporterit, si e vlerësojnë ndikimin e raporteve dhe punës së tyre dhe cilat konsiderojnë si parakushte për një Reporter Kombëtar.

Burime të tjera për këtë studim ishin faqja e internetit për trafikimin e qenieve njerëzore të Komisionit Evropian, faqet e internetit të vendeve anëtare të BE-së dhe institucioneve të ndryshme kombëtare, raportet vjetore të reporterëve kombëtarë, dokumente qeveritare dhe raportet nga GRETA (Komiteti Mbikëqyrës i Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore).

2. Vështrim i përgjithshëm mbi Reporterët Kombëtarë ose mekanizmat ekuivalente në vendet anëtare të BE-së

Që nga Direktiva e vitit 2011 për Trafikimin, thuajse të gjitha vendet anëtare të BE-së krijuan një Reporter kombëtar ose mekanizëm ekuivalent³. Përjashtim bëjnë Austria, Bullgaria, Qipro, Danimarka, Gjermania, Irlanda, Sllovenia dhe *Mbretëria e Bashkuar*. Megjithatë, Austria dhe Sllovenia kanë një Koordinator Kombëtar, i cili sipas informacionit të tyre, përmbush *de facto* rolin e Reporterit Kombëtar. Në Bullgari, Komisioni Kombëtar për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (NCCTHB), themeluar në vitin 2004, përmbush *de facto* rolin e Reporterit Kombëtar. E njëjta gjë vlen edhe për Qipron, ku Grupi Koordinues Multidisiplinar përmbush *de facto* rolin e Reporterit deri në emërimin e parashikuar të tij. Në Slloveni, Koordinatorin Kombëtar vepron *de facto* si Reporter Kombëtar.

³ Informacioni në këtë seksion bazohet kryesisht në faqen e internetit të Komisionit Evropian për trafikimin e qenieve njerëzore: https://ec.europa.eu/anti-trafficking/national-rapporteurs_en (parë më 16 gusht 2018). Megjithatë, informacioni në faqen e internetit të KE-së mund të jetë i papërditësuar. Informacioni për Spanjën vjen nga Raporti GRETA i vitit 2018, <https://www.coe.int/en/web/anti-human-trafficking/-/greta-publishes-second-report-on-spain>.

Një pjesë e mirë e shteteve të BE-së (15) kanë zgjedhur një mekanizëm ekuivalent me Raporterin Kombëtar. Në 7 shtete, Koordinatori Kombëtar ushtron edhe rolin e Raporterit Kombëtar (ose Raporteri Kombëtar ushtron rolin e Koordinatorit): Kroacia, Estonia, Greqia, Hungaria, Letonia, Malta, Portugalia dhe Republika Çeke.

Në 8 shtete të tjera, roli i Raporterit Kombëtar përmbushet nga një organ qeveritar, i cili mund të jetë Ministria e Brendshme (Lituania; Polonia; Sllovakia; Spanja; Rumania), policia/Ministria e Drejtësisë (Suedia) dhe deri tek Departamenti për Mundësi të Barabarta në Kryesinë e Këshillit të Ministrave (Itali).

Në 4 shtete funksioni i Raporterit Kombëtar i është caktuar një organi të pavarur: MYRIA, Qendra Federale e Migracionit (Belgjikë); Instituti Kombëtar i të Drejtave të Njeriut (Francë; Luksemburg); dhe Avokati i Popullit për Pakicat (Finlandë).

Tabela më poshtë jep një përmbledhje të mënyrës se si shtetet e ndryshme anëtare të BE-së kanë organizuar Raporterin Kombëtar ose mekanizmat ekuivalent, së bashku me detyrat e tij.

Pa Raporter Kombëtar (Zyrtar): Austri, Bullgari, Qipro, Danimarkë, Gjermani, Irlandë, Slloveni, MB (8)		
Austria	KK (2009) vepron <i>de facto</i> si RK. KK është vendosur në Ministrinë Federale për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare dhe gjithashtu shërben si Shef i Task Force-s Austriake kundër trafikimit.	Një nga prioritetet e Task Forcë-s është përmirësimi i mbledhjes së të dhënave për trafikimin e qenieve njerëzore, përfshirë identifikimin e viktimave.
Bullgaria	Komisioni Kombëtar për TQNJ (NCCTHB) (2004) përmbush <i>de facto</i> rolin e RK. NCCTHB është një organ kolektiv i Këshillit të Ministrave, i përbërë nga zyrtarë të nivelit të lartë të dymbëdhjetë ministrive dhe institucioneve.	Raporte vjetore për veprimtaritë e Sekretariatit të Komisionit dhe institucioneve përkatëse që janë anëtare të tij.
Qipro	Ligji 60(I) / 2014 parashikon një vlerësues të jashtëm të pavarur si RK, por ai / ajo nuk është emëruar ende. Deri atëherë, Grupi Koordinues Multidisiplinar përmbush <i>de facto</i> funksionin e RK. Grupi kryesohet nga Koordinatori Kombëtar, një funksion i mbajtur nga Ministri i Brendshëm. Anëtarët përfshijnë përfaqësues nga ministritë kompetente dhe agjencitë joqeveritare.	Përgjegjësitë e Grupit Koordinues Multidisiplinar përfshijnë hartimin e raporteve vjetore mbi zbatimin e legjislacionit të trafikimit, si dhe situatën e brendshme dhe atë ndërkombëtare për TQNJ. Raportet i paraqiten Dhomës së Përfaqësuesve pasi të jenë aprovuar nga Këshilli i Ministrave.

Danimarka	Danimarka nuk ka caktuar një RK. Sidoqoftë, Qendra Kombëtare e Hetimit (NCI) e Policisë Daneze dhe Qendra Daneze kundër Trafikimit Njerëzor (CMM) monitorojnë aktivitetet dhe ndikimin e përpjekjeve antitrafik në Danimarkë.	
Gjermania	Gjermania nuk ka zgjedhur një RK.	Policia Kriminale Federale (BKA) boton një Raport Vjetor të Situatës së Trafikimit të Qenieve Njerëzore që nga viti 1994. Në këtë raport përfshihen edhe rastet e punës së detyruar, të hetuara nga inspektorët e punës. Qëllimi i raportit të situatës është të sigurojë një përmbledhje të shkurtër të informacionit aktual mbi zhvillimet në fushën e TQNJ. Raporti u mundëson policëve dhe vendimmarrësve politikë të vlerësojnë shtrirjen e problemit dhe të planifikojnë në përputhje me rrethanat. Raporti i situatës është gjithashtu një bazë e rëndësishme për punën e Grupit Federal të Punës kundër Trafikimit të Grave.
Irlanda	Irlanda, vetëm kohët e fundit ka krijuar struktura të reja antitrafikimi dhe nuk e konsideron ngritjen e RK në këtë fazë.	
Sllovenia	Koordinatori Kombëtar (2002) vepron <i>de facto</i> si RK (2012). KK e ka selinë në Ministrinë e Brendshme.	KK përgatit raporte vjetore dhe dokumente strategjike që i paraqiten Qeverisë.
Mbretëria e Bashkuar	Mbretëria e Bashkuar nuk ka caktuar një RK. Roli i RK ushtrohet kryesisht nga Grupi Ministror Ndër-Departamentar (IDMG). IDMG mbështetet nga Qendra kundër Trafikimit të QNJ në Mbretërinë e Bashkuar (UKHTC), Agjencia Kufitare e Mbretërisë së Bashkuar dhe Grupi i Interesit të OJQ-ve.	IDMG ka përgjegjësi për mbikëqyrjen strategjike dhe monitorimin e politikës së MB për trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Megjithatë, mbledhja e të dhënave është përgjegjësi kryesore e UKHTC në bashkëpunim me agjencitë e zbatimit të ligjit. UKHTC vepron gjithashtu si një pikë qendrore e koordinimit për inteligjencën, analizën dhe aktivitetet operacionale rreth trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo lidhet ngushtë me agjencitë e zbatimit të ligjit në të gjithë vendin, me organizata joqeveritare, si dhe me Zyrën e Brendshme.

Koordinatori Kombëtar ushtron rolin e RK / RK ushtron rolin e KK: Kroacia, Estonia, Greqia, Hungaria, Letonia, Portugalia, Republika Ceke (7)		
Kroacia	KK ushtron rolin e RK. KK është drejtues i Zyrës Qeveritare për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave kombëtare.	
Estonia	KK (2006) ushtron rolin e RK. Pozicionin e mban një këshilltar i lartë i Ministrisë së Drejtësisë.	KK mbledh informacion mbi mbarëvajtjen e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit; mbledh të dhëna statistikore nga palë të ndryshme të interesuara; ofron raporte vjetore për qeverinë.
Greqia	RK (2013) emërohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme; RK është Shefi i Zyrës për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i cili përbëhet nga ekspertë të Ministrisë së Jashtme.	Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit koordinon Rrjetin e palëve të interesit, shtetërore dhe OJQ-ve, të cilat bashkëpunojnë në zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit; Siguron raporte vjetore.
Hungaria	KK (2008) ushtron rolin e RK. Pozicionin e mban Zëvendës Sekretari i Shtetit për BE-në dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare pranë Ministrisë së Brendshme.	Përgjegjësitë kryesore të Koordinatorit Kombëtar përfshijnë raportimin vjetor tek Qeveria, mbi hapat e ndërmarra gjatë vitit dhe për sfidat e mbetura.
Letonia	KK ushtron rolin e RK-së, me seli në Ministrinë e Brendshme.	KK-së i është ngarkuar detyra për të mbledhur dhe analizuar të dhëna nga institucione të ndryshme shtetërore dhe OJQ. KK raporton çdo vit pranë Kabinetit të Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit. Gjithashtu, Policia e Shtetit Leton përgatit një raport vjetor për përdorim të brendshëm mbi aktivitetet në fushën e luftimit të TQNJ.
Portugalia	KK (2008) ushtron rolin e RK. RK/ KK emërohet nga Komisioni për Shtetësi dhe Barazi Gjinore (CIG). CIG është pjesë e Presidencës së Këshillit të Ministrave dhe është nën varësinë e Sekretarit të Shtetit për Shtetësinë dhe Barazinë.	RK harton raporte vjetore mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit dhe raporton tek anëtarët e Qeverisë. Krahas RK, Observatori mbi TQNJ është i detyruar të prodhojë, mbledhë, analizojë dhe shpërndajë informacione mbi TQNJ dhe llojet e tjera të dhunës gjinore.
Republika Ceke	Roli i RK i është caktuar Departamentit të Politikave të Sigurisë (2003), pranë Ministrisë së Brendshme. Ky departament është gjithashtu përgjegjës për koordinimin e politikave të trafikimit.	Mbledhja e informacionit, analizimi dhe monitorimi; koordinimi i politikave antitrafik; paraqitja e raporteve dhe dokumenteve të politikave për qeverinë.

Funksioni i RK-së është pjesë e një ministrie: Italia, Lituania, Malta, Polonia, Rumania, Sllovakia, Spanja, Suedia (8)		
Italia	Funksioni i RK-së përmbushet nga Departamenti për Mundësi të Barabarta (DEO) i Kryesisë së Këshillit të Ministrave, autoriteti qendror përgjegjës për promovimin dhe koordinimin e politikave dhe veprimeve kundër TQNJ.	DEO gjithashtu vepron si vëzhgues kombëtar për TQNJ. Ai mbledh dokumente dhe raporte, informacione mbi kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe dokumente reference dhe gjykime në një ueb faqe të siguruar, në të cilën OJQ-të e regjistruara dhe autoritetet lokale kanë akses për të ngarkuar informacione mbi personat e trafikuar, të ndihmuar në programet e asistencës kombëtare. DEO përdor një bazë të dhënash të veçantë (SIRIT) për mbledhjen e informacionit mbi TQNJ, me qëllim monitorimin e fenomenit.
Lituania	Funksioni i RK-ë mbahet nga një zyrtar i Ministrisë së Brendshme (2016).	RK mbledh të dhëna statistikore dhe informacione të tjera të rëndësishme për aktivitetet dhe veprimet kundër TQNJ; kryen analizën e të dhënave dhe vlerëson tendencat dhe rezultatet e aktiviteteve dhe veprimeve kundër TQNJ; nxjerr rekomandime dhe ia paraqet Ministrit të Brendshëm, Komisionit të Koordinimit të Luftës kundër TQNJ dhe publikut. Ministri i Brendshëm informon Qeverinë për rekomandimet e RK.
Malta	Funksioni i RK përmbushet nga Komiteti i Monitorimit Kundër TQNJ, i kryesuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Sigurisë Kombëtare. Anëtarët përfshijnë Sekretarin e Përhershëm të Ministrisë për Familjen dhe Solidaritetin Social, Prokurorin e Përgjithshëm, Komisionerin e Policisë dhe Sekretarin e Përhershëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Sigurisë Kombëtare.	Komiteti është përgjegjës për të monitoruar zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit; vepron si RK dhe koordinon mbledhjen e të dhënave dhe raportimin pranë Komisionit të BE-së; gjithashtu rishikon politikën dhe praktikën në lidhje me zbatimin e Direktivës 2011/36/EU. Krahas RK, Malta ka një koordinator të veçantë anti-trafikimi.
Polonia	Ministria e Brendshme vepron si mekanizëm ekuivalent. Nuk ka asnjë informacion tjetër.	Polonia ka një koordinator kombëtar kundër trafikimit të veçuar.
Rumania	Funksioni i RK-së i është caktuar Agjencisë Kombëtare kundër Trafikimit të Personave (ANITP), me seli në Ministrinë e Punëve të Jashtme (2011).	ANITP koordinon, vlerëson dhe monitoron zbatimin e politikave të TQNJ nga autoritetet përgjegjëse dhe harton raporte vjetore. ANITP është gjithashtu përgjegjës për ruajtjen e Sistemit të Integruar për Monitorimin dhe Vlerësimin e Viktimave të Trafikimit (SIMEV) dhe luan një rol kryesor në mekanizmin e referimit. SIMEV është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar trendet dhe për t'i bërë ato të disponueshme për palët e interesuara, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për TQNJ.

Slovakia	Funksioni i RK-së përmbushet nga Qendra e Informacionit për Krimin dhe Parandalimin e TQNJ (ICCHTP), e cila është pjesë e Ministrisë së Brendshme (2009).	ICCHTP u krijua me qëllim mbledhjen e informacionit mbi viktimat e trafikimit, analizimin dhe vlerësimin e aktiviteteve si dhe shkëmbimin e informacionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Krahas RK-së, Sllovakia ka një koordinator AT (2005).
Spanja	Drejtori i Zyrës së Sekretarit të Shtetit për Siguri është emëruar si Raporter Kombëtar (2014). RK mbështetet nga Qendra e Inteligjencës kundër Terrorizmit dhe Krimin të Organizuar (CITCO), si hallkë themelore në fushën e TQNJ. Zyra e RK ka gjithsej një staf prej tre personash, përfshirë një zyrtar në CITCO.	Detyrat e RK-së përfshijnë mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e veprimtarive antitrafik të të gjitha institucioneve shtetërore; vlerësimin e tendencave në TQNJ; matjen e rezultateve të veprimeve; mbledhjen dhe analizimin e informacionit; identifikimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira; zhvillimin e treguesve të përbashkët për të lehtësuar krahasimin dhe konsistencën e informacionit. Ai gjithashtu përqendrohet në koordinimin e palëve të interesit, krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit dhe sigurimin e një roli më të madh për OJQ-të.
Suedia	Funksioni i RK-së përmbushet nga Bordi Kombëtar i Policisë (1998), i ndihmuar nga Departamenti Kombëtar i Hetimit Penal (NCID).	Detyra e RK/NCID është të mbledhë dhe përpunojë informacione mbi trafikimin brenda dhe përmes Suedisë dhe të vlerësojë efektivitetin e veprimeve për zbatimin e ligjit, si dhe masat apo iniciativat ligjore, politike dhe praktike. RK/NCID i dërgon Qeverisë raporte vjetore monitorimi. Informacioni mbledhet përmes 7 rajoneve të policisë, Bordit Administrativ të Qarkut (Koordinatorit Kombëtar), Agjencisë së Migracionit, shërbimit social dhe OJQ-ve të Platformës së Shoqërisë Civile Suedeze.
Funksioni i RK-së është pjesë e një organi të pavarur: Belgjika, Finlanda, Franca, Luksemburgu (4)		
Belgjika	Funksioni i RK është kombinimi i Myria, Qendra Federale e Migracionit, si raporter i pavarur (2014) dhe Njësisë Koordinuese Ndër-sektoriale kundër TQNJ (ICU) si organ koordinues dhe relator i Shtetit.	Myria është një organ publik i pavarur. Misioni i saj është të sigurojë mbrojtjen e të drejtave themelore të emigrantëve; të informojë autoritetet publike për natyrën dhe shtrirjen e trendeve të migracionit; dhe të stimulojë luftën kundër trafikimit njerëzor dhe kontrabandës. Myria ka fuqinë të ndërmarrë veprime juridike dhe të veprojë si palë civile në çështjet e trafikimit. Detyra kryesore e ICP-së është koordinimi dhe prezantimi i një politike.
Franca	Instituti Kombëtar i të Drejtave të Njeriut është caktuar si RK i pavarur (2014).	Krahas Komisionit si RK, Franca ka një Koordinator të veçantë Kombëtar.

Luksemburgu	Instituti Kombëtar i të Drejtave të Njeriut është caktuar si RK i pavarur (2014).	Raporteri kombëtar përcakton tendencat në trafikimin e qenieve njerëzore dhe vlerëson rezultatet e veprimeve të ndërmarra për të luftuar këtë fenomen, përfshirë mbledhjen e statistikave në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile në këtë fushë; harton të paktën çdo dy vjet raporte për Dhomën e Deputetëve.
Finlanda	Avokati i Popullit për Pakicat vepron si RK (2009).	RK mbledh dhe analizon të dhëna për trafikimin, monitoron ndikimin dhe efektivitetin e politikave kombëtare dhe ka të drejtë të ndërhyjë në raste individuale. RK është një autoritet i pavarur me zyrën e tij të veçuar. RK raporton çdo vit në qeveri dhe çdo 4 vite në parlament. Krahas RK, Finlanda ka një strukturë të veçantë qeveritare për koordinimin e veprimeve kundër trafikimit, të përbërë nga disa palë.
RK është agjenci e pavarur e veçantë (1)		
Holanda	Raporteri Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (2000) dhe (që nga 2011) Dhunën Seksuale ndaj Fëmijëve.	RK mbledh informacione mbi natyrën dhe shkallën e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe dhunën seksuale ndaj fëmijëve. RK është një autoritet i pavarur, ka zyrën e tij / saj dhe raporton në qeveri.

RK=Raporteri Kombëtar / KK=Koordinatori Kombëtar

Pothuajse në të gjitha vendet, Raporteri Kombëtar është pjesë e qeverisë. Në 7 shtetet ku Koordinatori Kombëtar ushtron rolin e Raporterit, ai vendoset në Ministrinë e Brendshme (3), Ministrinë e Punëve të Jashtme (1) dhe Ministrinë e Drejtësisë (1). Vetëm në 2 shtete, Koordinatori është nën një organ qeveritar të orientuar tek të drejtat e njeriut: në një rast nën Zyrën e Qeverisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Minoriteteve Kombëtare (Kroaci) dhe në rastin tjetër nën Komisionin për Shtetësi dhe Barazi Gjinore (Portugali).

Në 8 shtetet ku Raporteri Kombëtar është pjesë e një ministrie, ai i përket Ministrisë së Brendshme (6) ose policisë (Ministrisë së Drejtësisë) (1). Në 1 shtet, Raporteri i përket Departamentit të Mundësive të Barabarta (Itali).

Në 4 shtete, Raporteri Kombëtar është pjesë e një organi të pavarur: në 2 shtete pjesë e Institutit Kombëtar të të Drejtave të Njeriut, në 1 shtet e Avokatit të Popullit për Pakicat dhe në 1 vend tjetër pjesë e Qendrës Federale të Migracionit. Në vetëm 1 shtet, Raporteri Kombëtar është një organ i pavarur që funksionon më vete.

Raporteri Kombëtar vendoset në:	
Ministrinë e Brendshme (Republika Çeke; Hungaria; Letonia; Lituania; Malta; Polonia; Rumania; Sllovakia; Spanja)	9
Ministrinë e Punëve të Jashtme (Greqia)	1
Ministrinë e Drejtësisë / Policinë (Estonia; Suedia)	2
Organin qeveritar për të drejtat e njeriut / Barazinë gjinore / Dep. E mundësive të barabarta (Finlanda; Italia; Portugali)	3
Institutin e të Drejtave të Njeriut (Francë; Luksemburg)	2
Avokatin e Popullit për Minoritetet (Finlandë)	1
Qendrën Federale e Migracionit (Belgjikë)	1
Zyrë e veçantë, e pavarur (Holandë)	1
Total	20

Duke parë pozicionimin e Raporterit Kombëtar, fokusi kryesor qëndron në trafikimin ndërkufitar dhe atë të qenieve njerëzore si vepër penale dhe më pak në trafikimin si shkelje e të drejtave të njeriut.

3. Holanda⁴

Bazat e emërimit të Raporteres së parë Kombëtar për Trafikimin e Grave në vitin 2000, Znj. Anna Korvinus, u hodhën nga Deklarata e Hagës në 1997. Raporteri është themeluar si organ i pavarur, në kuadrin e politikës së emancipimit. Pritej që kërkimi i integruar mbi trafikimin dhe rekomandimet e mundshme të kontribuonin ndjeshëm në përmirësimin e luftës kundër këtij fenomeni. Pas zgjerimit të përkufizimit të trafikimit në Kodin Penal Holandez në 2005, në përputhje me Protokollin e KB për Trafikimin, mandati i Raporterit Kombëtar u përshtat për të përfshirë trafikimin e grave, burrave dhe fëmijëve në të gjitha format e tij.

Në vitin 2009, mandati i Raporterit u zgjerua duke përfshirë pornografinë e fëmijëve. Ky zhvillim u diktua nga një nevojë urgjente, pasi disa organizata kishin vërejtur një rritje të numrit të imazheve dixhitale të fëmijëve të abuzuar seksualisht. Agjenci të ndryshme kërkuan krijimin e një "autoriteti kombëtar" dhe propozuan që hetimi ose monitorimi i përpjekjeve për të luftuar pornografinë e fëmijëve mund t'u shtohet përgjegjësive të Raporterit Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (BNRM 2010, f. 22). Në vitin 2011, mandati i Raporterit u zgjerua më tej për të përfshirë edhe dhunën seksuale ndaj fëmijëve në përgjithësi.

4 Burimet: Intervistë me znj. Corinne Dettmeijer, Raporter Kombëtar 2006-2017, 31 maj 2018; Uebfaqja e Raporterit Kombëtar <https://www.nationaalrapporteur.nl/>; TK 26 206, nr. 15, Politika e Emancipimit 1999, Letër e Ministrit të Drejtësisë, 29 Qershor 1999; Raporteri Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 'Trafficking in Human Beings. 10 years of independent monitoring', Hagë: BNRM 2010. https://www.nationaalrapporteur.nl/binaries/8e-rapportage-nrm-engweb-tcm64-310472_tcm23-34822.pdf.

Pozicioni i pavarur

Në kohën e krijimit të Raporterit Kombëtar, zgjedhja e një pozicioni të pavarur u bë në mënyrë eksplicite. Siç argumentohet në vitin 1999 nga Ministri i Drejtësisë në letrën e tij drejtuar Parlamentit:

“Sapo ky zyrtar të jetë në një lloj marrëdhënie fikse me një prej organeve që (mund) të kenë interes për rezultatet e kërkimit dhe përfundimet e tij, ai pa dashur mund të ndikohet nga kjo. Pozicionimi i byrosë duhet gjithashtu ta garantojë këtë pavarësi” (Letra e Ministrit 29 qershor 1999, TK 26 206, nr. 15).

Për më tepër, u diskutua se Raporteri Kombëtar duhet të jetë dikush me autoritet të madh personal, i cili disponon ekspertizën e nevojshme dhe ka afinitet me temën: “jo vetëm për shkak të rëndësisë së temës, por edhe për të lehtësuar qasjen në institucionet, ku informacioni dhe bashkëpunimi i të cilave do të jetë i domosdoshëm”. Që nga Nëntori 2013, pozicioni i pavarur i Raporterit Kombëtar rregullohet me ligj në Holandë: ‘Raporteri Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Dhunën Seksuale ndaj Fëmijëve (Akti i themelimit)’⁵.

Mandati

Detyra e Raporterit Kombëtar është që çdo vit të raportojë mbi natyrën dhe shkallën e trafikimit të qenieve njerëzore, mekanizmat që luajnë rol në këtë fenomen, si dhe zhvillimet dhe efektet e politikave antitrafik. Raporteri nuk ka detyra ekzekutive në nivelin operacional.

Detyrat zyrtare të Raporterit, siç përcaktohen me Ligjin për themelimin e Raporterit të vitit 2013, janë:

- të kryejë kërkim në lidhje me shkallën dhe natyrën e trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve, si dhe efektet e politikave të ndërmarra për të trajtuar këto fenomene;
- t’i ofrojë këshilla qeverisë mbi politikat për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe dhunën seksuale ndaj fëmijëve;
- t’i raportojë periodikisht qeverisë duke i dërguar raporte Ministrit të Sigurisë dhe Drejtësisë, në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe dhunën seksuale ndaj fëmijëve.

Për më tepër, Akti thekson se raportet duhet të përmbajnë së paku:

- një shpjegim të metodave kërkimore;
- rezultatet e kërkimit të kryer dhe konkluzionet e nxjerra prej tij;
- rekomandime për përmirësime në politikat për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve. Rekomandimet mund t’i adresohen autoriteteve qendrore, lokale dhe organeve të tjera

⁵ Për një version të përkthyer të Aktit që themeloi Raporterin Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore shih: https://www.dutchrapporteur.nl/binaries/Act%20establishing%20the%20National%20Rapporteur_tcm24-56570.pdf

administrative, organizatave ndërkombëtare, organizatave joqeveritare dhe palëve të tjera të interesit.

Mandati i Raporterit Kombëtar zgjat katër vite, me mundësinë e rizgjedhjes për një mandat të dytë. Një vlerësim mbi funksionimin e institucionit kryhet çdo 4 vite.

Që nga fillimi i punës së tij, Raporteri është mbështetur nga zyra mbështetëse. Aktualisht ai ndihmohet nga një ekip prej 14 anëtarësh, të cilët së bashku përbëjnë Byronë e Raporterit Kombëtar (BNRM). Anëtarët e stafit të byrosë janë ekskluzivisht përgjegjës për punën e tyre tek Raporteri Kombëtar.

Raportet

Raporteri Kombëtar i paraqet raporte vjetore Ministrisë të Drejtësisë, shpesh duke u përqendruar në një temë specifike, p.sh. zbatimi i parimit të mos dënimit. Rekomandimet mund të përfshijnë një gamë të gjerë çështjesh dhe mund të drejtohen në palë të ndryshme, përfshirë qeverinë, pushtetin lokal dhe OJQ-të.

Qeveria u përgjigjet raporteve dhe informon Parlamentin për përfundimet e tij. Në përgjithësi, qeveria publikon një reagim ndaj raporteve të Raporterit, i cili më pas bëhet objekt i një debati parlamentar. Raportet dhe botimet e tjera të Raporterit Kombëtar janë publike dhe mund të gjenden në faqen e tij të internetit: <https://www.nationaalrapporteur.nl/publicaties/>

Grumbullimi i të dhënave dhe e drejta për të kërkuar informacion

Zyra e Raporterit Kombëtar (BNRM) mbledh të dhëna sasiore dhe cilësore. Kjo bëhet përmes kërkit, analizës dytësore të bazave ekzistuese të të dhënave, duke organizuar takime dhe duke ndjekur konsulta të rregullta. BNRM gjithashtu merr pjesë në komisione rishikimi për studimet mbi trafikimin ose tema të ngjashme dhe në forume ndërkombëtare, p.sh. mbi politikën e BE-së për të luftuar trafikimin.

Sipas mandatit të tij fillestar, Raporteri është i autorizuar t'u drejtohet të gjitha organeve ose institucioneve që mund të disponojnë informacionin përkatës. Nga ana e tyre, këto organe ose institucione janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe të japin informacionin e kërkuar (përveç rastit kur kërkesa është në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore). Informacioni mund të përfshijë gjithashtu të dhëna personale të viktimave. Megjithatë, nëse Raporteri dëshiron t'i përdorë këto të dhëna, ato duhet të përpunohen në mënyrë që të mos identifikojnë individë. Raporteri mund të mos kufizohet vetëm në të dhënat që disponon, por ka mundësinë të fillojë edhe hetime me iniciativën e tij. Raporteri nuk ka kompetenca hetimore penale dhe nuk mund të trajtojë ankesa individuale.

Të dhënat sasiore janë të rëndësishme, por ndonjëherë ato mund të paraqesin një imazh të shtrembëruar të situatës aktuale. Siç theksohet në disa raporte, Raporteri e konsideron hulumtimin cilësor si thelbësor për një pasqyrim më të thellë të trafikimit. Raporteri mund të rekomandojë kryerjen e kërkimeve për tema specifike, por gjithashtu mund të kryejë hulumtimin e tij. Studimet e Raporterit përfshinin p.sh. shfrytëzimin në industrinë e seksit, nevojat për hetime financiare, analiza të praktikës gjyqësore për trafikimin e

qenieve njerëzore në industrinë e seksit në periudhën 2009-2012⁶, rolin e profesionistëve të mjekësisë në identifikimin e viktimave, politikat rajonale për trafikimin dhe aplikimin e periudhës së reflektimit.

Për të dhënat mbi numrin dhe situatën e viktimave (të mundshme), sektorët në të cilët janë shfrytëzuar, etj., Raporteri shfrytëzon bazat e të dhënave të CoMensha, Qendrës Kombëtare të Koordinimit mbi Trafikimin e Njerëzve. CoMensha është pikë thelbësore për ndihmën fillestare dhe regjistrimin e viktimave (të mundshme) të trafikimit njerëzor. Të gjitha agjencitë që kanë kontakt me një viktimë (të mundshme) janë të detyruara të njoftojnë CoMensha, përfshirë policinë, inspektoratin e punës, strehëzat, ofruesit e shërbimeve, etj. Të gjitha të dhënat që CoMensha i ofron BNRM-së janë anonime. CoMensha nuk jep të dhëna individuale për viktimat.

Vlera e shtuar e një Raporteri Kombëtar në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, ndikimi & parakushtet

Me kalimin e viteve, rekomandimet e Raporterit Kombëtar kanë pasur një rol të rëndësishëm në krijimin e politikave holandeze kundër trafikimit. Raporteri mund të përdorë ekspertizën dhe informacionin e krijuar ndër vite për të fokusuar vëmendjen tek subjekte specifike, përshpejtuar ndryshimet, promovuar praktika të mira, ekspozuar ngërçe, për të bërë sugjerime dhe herë pas here, për të ndërhyrë në një rast individual. Shumë nga rekomandimet e Raporterit janë miratuar nga qeveria dhe drejtpërdrejt ose indirekt kanë çuar në përmirësime politikash, përmes përfshirjes së tyre në Planet Kombëtare të Veprimit kundër Trafikimit të Njerëzve. Një vlerësim 10-vjeçar i Raporterit Kombëtar dhe rezultatet e tij mund të gjenden në raportin e 8-të vjetor 'Trafikimi i Qenieve Njerëzore. 10 vjet monitorim i pavarur' (https://www.nationaalrapporteur.nl/binaries/8e-rapportage-nrm-engëeb-tcm64-310472_tcm23-34822.pdf)

Bazuar në përvojën e saj të gjatë si Raportere Kombëtare, Znj. Dettmeijer rendit parakushtet e mëposhtme për funksionimin efektiv të këtij organi ose një mekanizmi ekuivalent.

Pavarësia

Raporteri Kombëtar duhet të jetë i pavarur në përzgjedhjen e asaj që do të hetojë. Ai duhet të jetë në gjendje t'i përgjigjet zhvillimeve të fushës dhe të zhvillojë një 'nuhatje' për atë që i duhet kësaj të fundit. Statistikat janë të nevojshme, por analizimi i të dhënave dhe zbulimi i asaj që kërkon hetim të mëtejshëm është po aq i rëndësishëm dhe jo i parashikueshëm.



Corinne Dettmeijer

⁶ Studimi i fundit është publikuar edhe në gjuhën angleze: https://www.nationaalrapporteur.nl/binaries/nationalrapporteur-on-trafficking-in-human-beings-and-sexual-violence-against-children.case-law-on-trafficking-2009-2012-interactive-def_tcm23-34764.pdf

Aksesi në institucione

Raporteri duhet të ketë një distancë të caktuar nga institucionet qeveritare, por në të njëjtën kohë edhe një qasje të mjaftueshme dhe të lehtë tek këto institucione. Nga ana tjetër, siç është vërejtur nga Znj Dettmeijer, në disa vende mund të jetë një avantazh të jesh pjesë e qeverisë, ose të paktën të kesh akses tek persona të lartë në hierarkinë e saj. Një nga avantazhet mund të jetë qasja më e lehtë në të dhëna, p.sh. për të lidhur të dhënat nga burime të ndryshme. Kjo do të jetë më e rëndësishme në bazë të ligjit të ri evropian për mbrojtjen e të dhënave (GDPR). Përgjigja se cili është pozicioni më i mirë varet gjithashtu nga sistemi kombëtar. Holanda, për shembull, është mjaft e përqendruar në vetë-kritikë, por kjo nuk vlen për të gjitha vendet. Ajo që funksionon më mirë varet shumë nga konteksti kombëtar.

Autoriteti personal

Raporteri Kombëtar duhet të jetë dikush me autoritet. Ai/ajo duhet të ketë një autoritet të mjaftueshëm për të qenë kritik (pa pasur frikë që të humbasë pozitën e tij / saj) dhe kritikën nga ai/ajo duhet të pranohen. Gjithashtu, në rastin e një mekanizmi ekuivalent, është mirë që të vendoset në drejtim një figurë me autoritet.

Aksesi në të dhëna

Raporteri Kombëtar duhet të ketë një qasje të mirë në të dhëna në disa burime. Kjo vlen jo vetëm për të dhënat e autorëve, por edhe të viktimave.

Baza ligjore & mandati i gjerë

Pozicioni i Raporterit duhet të ketë një bazë ligjore, përfshirë rregullimin e aksesit në të dhëna. Kjo është e rëndësishme veçanërisht kur punohet me të dhëna sensitive. Një kornizë ligjore është gjithashtu e rëndësishme për të siguruar vazhdimësinë e institucionit. Më e mira është të sigurohet një mandat i gjerë që lejon fleksibilitet dhe bën të mundur përgjigjen ndaj zhvillimeve të reja.

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut

Ekzistojnë qasje të ndryshme të mundshme për Raporterët Kombëtarë dhe ka dallime të qarta midis tyre. Fokusi i Raporterit Holandez ka qenë gjithmonë i drejtuar nga mbrojtja e viktimave, më tepër sesa nga mbrojtja e kufijve. Për më tepër, fokusi nuk ka qenë vetëm në trafikimin ndërkuftar, por shumë vëmendje i kushtohet edhe trafikimit të brendshëm.

Qasja në çdo institucion dhe 'ura lidhëse'

Raporteri duhet të ketë akses në të gjitha institucionet dhe të shërbejë si urë lidhëse ndërmjet institucioneve të ndryshme.

Një shoqëri civile e zhvilluar

Shoqëria civile duhet të jetë mjaft e zhvilluar, përndryshe Raporteri është thjesht një zgjatim i qeverisë. Ai duhet të shërbejë si pikë kryesore dhe të ketë një rol lidhës, duke e parë 'nga lart' të gjithë procesin.

Llogaridhënie tek qeveria apo Parlamenti?

Në Holandë, Raporteri jep llogari tek qeveria, por zgjedhja varet edhe nga konteksti kombëtar. Të dyja janë të mundshme. Një raportim përpara parlamentit mund të garantonte me shumë transparencë.

4. Finlanda⁷

Raporteri i parë Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore në Finlandë u emërua në vitin 2009. Vendimi për të emëruar një Raporter u mor pas një rekomandimi të Komitetit të Koordinimit Finlandez për Trafikimin e Qenieve Njerëzore, i kryesuar nga Ministria e Brendshme finlandeze.

Avokati i Popullit për Pakicat si Raporter Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore

Sipas Raporterit të parë, Johanna Suurpää, kur u mor vendimi për krijimin e një Raporterit të pavarur kombëtar, preferenca e parë ishte krijimi i institucionit si pjesë e një organizate ekzistuese. Kriteri më i rëndësishëm ishte që Raporteri të caktohet në një organizatë të pavarur qeveritare. Avokati i Popullit për Pakicat e plotësoi këtë kriter (BNRM 2010, f. 20). Detyra e Ombudsmanit të Mosdiskriminimit është të promovojë barazinë dhe të parandalojë diskriminimin. Ai është një autoritet i pavarur dhe autonom, i vendosur administrativisht në Ministrinë e Drejtësisë.

Mandati i Raporterit u formulua në mënyrë të gjerë, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore dhe fushat e ndërlidhura, si shfrytëzimi për prostitucion dhe disa forma serioze të diskriminimit. Pozicioni i tij si pjesë e një institucioni për të drejtat e njeriut, i lejon Raporterit t'i qaset trafikimit, para së gjithash, si një problem i të drejtave të njeriut. Një karakteristikë e veçantë është se Raporteri Kombëtar ka të drejtë të ndërhyjë në raste individuale.

Mandati

Sipas propozimit të qeverisë të vitit 2008, detyrat e Raporterit Kombëtar përfshijnë mbledhjen e të dhënave për trafikimin e qenieve njerëzore nga autoritetet dhe në disa raste nga ofruesit e shërbimeve, së bashku me analizimin e këtyre të dhënave (Raporti 2014, f. 13). Më tej, ato përfshijnë monitorimin e veprimeve kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në mënyrë që të identifikojnë pikat problematike, trafikimin e qenieve njerëzore në përgjithësi, respektimin e detyrimeve ndërkombëtare dhe efektivitetin e legjislacionit kombëtar. Raporteri mund të japë sugjerime, rekomandime, deklarata, këshilla dhe të monitorojë realizimin e të drejtave të viktimave.

⁷ Burimet: Intervistë me znj. Venla Roth, zyrtar i lartë i Raporterit Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore, 28 Qershor 2018; faja në internet e Raporterit finlandez <https://www.syrjinta.fi/web/en/rapporteur-on-trafficking>; Intervistë me Johanna Suurpää në: National Rapporteur on Trafficking in Human Beings (2010), Trafficking in Human Beings. 10 years of independent monitoring, Hagë: BNRM; Raporteri Kombëtar Finlandez për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (2010), Raport 2010: Trafficking in human beings, phenomena related to it, and implementation of the rights of human trafficking victims in Finland, Helsinki 2010; Raporteri Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (2014), Raporti 2014: Assessment of the current state of action against human trafficking and of the fulfilment in criminal proceedings of the rights of victims of human trafficking subjected to sexual exploitation Ombudsman for Minorities, Grano: Ombudsman për pakicat.

Raporteri është i autorizuar të monitorojë situatën në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në një spektër të gjerë, duke përfshirë jo vetëm veprat penale të TQNJ, por edhe veprat e lidhura me këtë fenomen, veçanërisht diskriminimin në punë dhe prokurimin e mjeteve për të lehtësuar hyrjet ilegale në rrethana rënduese. Detyrat dhe kompetencat e Raporterit Kombëtar përcaktohen në Ligjin e vitit 2001 mbi Avokatin e Popullit për Pakicat dhe Gjykatën Kombëtare të Diskriminimit (660/2001). Sipas këtij ligji, Avokati i Popullit vepron si Raporter Kombëtar:

- monitoron fenomenet në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare dhe efektivitetin e legjislacionit kombëtar;
- nxjerr propozime, rekomandime, opinione dhe këshilla në lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe për realizimin e të drejtave të viktimave;
- mban kontakte me organizatat ndërkombëtare për çështjet e trafikimit të QNJ;
- ofron këshillim juridik dhe ndihmon viktimat sipas nevojës;
- raporton rregullisht në Qeveri dhe Parlament.

Ndryshe nga Raporteri holandez, ai finlandez mund të ofrojë gjithashtu këshillim juridik për viktimat dhe në raste të jashtëzakonshme, të ndihmojë viktimat në çështjet gjyqësore. Siç thuhet në nenin 4 të Aktit të 2001, Raporteri Kombëtar mund të

“ndihmojë ose të caktojë një zyrtar vartës për të ndihmuar një viktimë të diskriminimit etnik ose një viktimë të mundshme të trafikimit QNJ, në sigurimin e të drejtave ose, nëse është e nevojshme, të japë asistencë juridike për personin për këtë qëllim, nëse mendon se çështja është me rëndësi të konsiderueshme për parandalimin e diskriminimit etnik ose për sigurimin e të drejtave të një viktimë të mundshme të trafikimit njerëzor” (Raporti 2014, f. 13)

Kjo përfshin të drejtën për të lëshuar mendime për raste specifike me kërkesë të klientit. Raporteri gjithashtu mund të japë këshilla ligjore për viktimat e trafikimit njerëzor, palët që ndihmojnë këto të fundit dhe autoritetet. Për më tepër, Raporteri Kombëtar, me iniciativën e vet, mund të adresojë çdo mangësi të vërejtur në hetimin e veprave të trafikimit QNJ dhe trajtimin e viktimave.

Kjo do të thotë që ai mund të konsultohet nga individë, OJQ, policia, prokurorë etj. Raporteri mund të japë deklarata në gjykatë, të thërrasë bashkitë për sqarime pse një viktimë nuk merr shërbimet e caktuara, etj. Nëse shërbimet refuzohen, OJQ-të për shembull, mund të thërrasin Avokatin e Popullit, i cili në vetvete tashmë po ndihmon. Siç u tha nga Znj. Venla Roth, eksperte e lartë në Zyrën e Raporterit Kombëtar:

“OJQ-të e perceptojnë këtë si shumë të dobishme, duke ditur që ekziston një institucion që mund të ndërhyjë. Ne nuk e bëjmë atë shumë shpesh, por e bëjmë në raste kur asgjë tjetër nuk po ndihmon. Kështu ne ndërhyjmë”.

E drejta për të ndërhyrë në raste individuale bazohet në të drejtën për të marrë informacion të klasifikuar dhe për të konstatuar të meta dhe mangësi në sistem. Kjo konsiderohet një pjesë e rëndësishme e mandatit të Raporterit Kombëtar. Siç shprehet Znj Roth:

“Raportimi është i rëndësishëm, por për të ditur me të vërtetë se çfarë ndodh në terren në lidhje me viktimat dhe në sistem, informacioni nga niveli bazë është thelbësor. Ne jemi në gjendje të raportojmë dhe diskutojmë problemet sepse ne e dimë se çfarë ndodh”.

Raporteri nuk ka autorizim të ngrejë ankesa individuale. Por, ka një diskutim të vazhdueshëm nëse ai duhet të ketë të drejtë të trajtojë ankesa për ligjshmërinë e veprimeve të qeverisë. Sidoqoftë, kjo do të kërkonte shumë më tepër fonde.

Krahas kontributit në parandalimin dhe luftimin e trafikimit, avancimin e identifikimit, ndihmës për viktimat dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik, një pjesë e rëndësishme e punës së Raporterit Kombëtar është mbështetja e zyrtarëve dhe OJQ-ve të angazhuara në adresimin e trafikimit dhe ndihmën për viktimat.

Një aspekt tjetër thelbësor i punës së tij është përmbushja e të drejtave të viktimave dhe faktorët që mund ta pengojnë këtë, qoftë legjislativë apo administrativë. Raporteri kërkon të nxjerrë në pah këndvështrimin e viktimave dhe ndikimet e legjislacionit, praktikat aktuale ose mos ndërhyrjen mbi viktimat e trafikimit dhe përmbushjen e të drejtave të tyre.

Raporteri punon me një këndvështrim të fortë mbi të drejtat e njeriut. Kjo pasqyrohet edhe në metodologjinë që ai përdor: hapi i parë është identifikimi i problemit bazuar në të dhënat dhe analizën e tij. Më pas, krahasohet situata me detyrimet kombëtare, të BE-së dhe ato ndërkombëtare: a është situata në përputhje me ligjin? Nëse jo, ai përpiqet të japë një rekomandim se si mund të përmirësohet situata. Ky mund të jetë një ndryshim i ligjit ose një ndryshim në interpretimin ose zbatimin e ligjit. Për shembull, numri i viktimave të identifikuar të shfrytëzimit seksual është jashtëzakonisht i ulët. Hulumtimet nga Raporteri treguan se ndihma për viktimat dhe policia janë aq të lidhura me njëra-tjetrën, sa viktimat nuk guxojnë të shkojnë në polici. Kjo çoi në një rekomandim mbi nevojën për të ndarë sistemin e drejtësisë penale dhe sistemin e ndihmës së viktimave.

Qëllimi përfundimtar është avancimi i veprimeve kundër trafikimit. Kjo bëhet përmes mjeteve të ndryshme, p.sh. pjesëmarrja në projekte për të përmirësuar legjislacionin; ofrimi i trajnimeve mbi trafikimin për avokatët, autoritetet e hetimit penal, prokurorët dhe personelin e gjykatës; lëshimi i rekomandimeve; pjesëmarrja në seminare (ndërkombëtare) dhe debate publike; ofrimi i këshillave; intervistimi i viktimave për përvojat e tyre në Finlandë, etj.

Bashkëpunimi me OJQ-të

Raporteri Kombëtar mban kontakte të ngushta me OJQ-të përkatëse përmes takimeve, diskutimeve, konsultimeve të rregullta, etj. Kur harton një deklaratë, ai zakonisht konsultohet edhe me OJQ-të.

Stafi

Një nga problemet me të cilat përballet që në fillim Raporteri janë burimet e kufizuara. Zyra e Avokatit të Popullit ka 16 punonjës të përhershëm, nga të cilët një ekspert me kohë të plotë është caktuar për të ndjekur trafikimin e qenieve njerëzore. Ky i fundit ndonjëherë mbështetet përkohësisht nga stafi i punësuar nëse ka fonde shtesë.

Raportet

Raporteri Kombëtar i paraqet Qeverisë raporte vjetore dhe raporte 4-vjeçare, të cilat përmbajnë rekomandime për Parlamentin, d.m.th. një herë në çdo periudhë elektorale.

Një nga qëllimet kryesore të raportimit është përdorimi i informacionit të mbledhur për të evidentuar mangësitë në veprimet kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe adresimin e tyre, përfshirë nxjerrjen e rekomandimeve për zhvillimin e veprimeve kundër TQNJ (raporti 2014:f. 18).

Raporti në Parlament përmban një vlerësim të gjerë të gjendjes aktuale të Finlandës në lidhje me veprimet kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përfshirë rekomandimet për përmirësim. Raporti vjetor i paraqitur Qeverisë në përgjithësi është një përmbledhje e veprimeve të vitit të kaluar ose një raport tematik për një çështje specifike në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore. Përmes raporteve vjetore gjithashtu monitorohet zbatimi i rekomandimeve të raporteve dërguar Parlamentit.

Raportet 4-vjeçare diskutohen nga Komisionet Parlamentare dhe Raporteri jep një deklaratë në seancën plenare të Parlamentit. Komisioni kryesor për Avokatin e Popullit dhe Raporterin është Komisioni i Punësimit dhe Barazisë.

Kur miratohet, qeveria duhet të ndjekë rekomandimet e shprehura në të. Në këtë mënyrë mund të ndryshohen dispozitat ligjore, p.sh. ato penale. Një shembull konkret është një raport i përkohshëm për gratë Nigeriane. Sipas traktatit të Dublinit, ato u dërguan përsëri në Itali ku u shfrytëzuan, pa një vlerësim individual nëse ishin të sigurta. Raporteri konsideroi se kjo ishte në kundërshtim me detyrimin e Finlandës sipas nenit 16 të Konventës së Këshillit të Evropës kundër Trafikimit. Rrjedhimisht, kjo ka sjellë një ndryshim në zbatimin e ligjit.

Raportet dhe botimet e tjera të Raporterit Kombëtar janë publike dhe mund të gjenden në faqen e tij të internetit <https://www.syrjinta.fi/web/en/rapporteur-on-trafficking>. Të gjitha raportet janë në dispozicion në gjuhët zyrtare të Finlandës dhe janë përkthyer edhe në anglisht.

Mbledhja e të dhënave dhe e drejta për të përftuar informacion

Raporteri Kombëtar ka të drejtë (pavarësisht nga dispozitat e konfidencialitetit) të marrë informacion nga autoritetet, nga ofruesit e shërbimeve mbështetëse për viktimat e trafikimit dhe nga organet që marrin ndihmë nga qeveria në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Siç thuhet në Aktin e vitit 2001, Avokati i Popullit ka të drejtë të marrë falas nga autoritetet e tjera çdo informacion të nevojshëm për të kryer detyrat e përcaktuara në këtë Akt dhe në Aktin për të huajt (301/2004), pavarësisht nga dispozitat mbi konfidencialitetin.

Siç u theksua në raportin e Raporterit për vitin 2014, marrja e informacionit në praktikë rezulton të jetë një detyrë sfiduese (f. 14). Kjo ndodh veçanërisht në situatat kur Raporteri Kombëtar e konsideron të rëndësishme të zbulojë nëse në çështjet penale në vazhdim mbi trafikimin janë garantuar të drejtat e palëve të dëmtuara (të mundshme) dhe nëse viktimat e mundshme janë referuar në sistemin e ndihmës. Për të adresuar këtë problem, Bordi Kombëtar i Policisë nxori udhëzime speciale. Këto udhëzime tregojnë se kur Raporteri kërkon informacione specifike nga policia, ato duhet të jepen pa vonesë, përveç rastit kur kjo mund të rrezikojë hetimin. Kur një hetim penal ose një hetim policor është në proces, i takon kryesuesit të hetimit të vendosë masën e dhënies së informacionit. Udhëzimet gjithashtu këshillojnë kreun e hetimit të njoftojë Raporterin për çdo hetim penal mbi trafikimin e qenieve njerëzore, jo më vonë se kur policia fillon intervistimin e

viktimave (të dyshuara). Në fund, ato rekomandojnë që t'i dërgohet Raporterit një kopje e rekordeve të hetimit penal, pasi ky i fundit të ketë përfunduar, në të njëjtën kohë kur ato i dërgohen palëve të çështjes dhe prokurorit.

Raporteri ka të drejtë të marrë informacione nga ofruesit e shërbimeve të përmendura në Ligjin për Integrimin e Emigrantëve dhe Pritjen e Azilkërkuësve ose nga ata, të cilët marrin ndihmë shtetërore për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Kjo përfshin të dhëna personale të viktimave, nëse një informacion i tillë është i nevojshëm për të kryer detyrat e tij.

Raporteri nuk mbledh në mënyrë sistematike të dhëna personale. Në praktikë kjo ndodh vetëm kur atij i kërkohet të ndërmarë veprime për një rast individual. Fokusi i tyre është mënyra se si janë përmbushur të drejtat në sistem, si funksionon sistemi dhe si mund të sigurojë të drejtat e viktimave.

Ashtu si Raporteri holandez, ai finlandez thekson rëndësinë e studimeve cilësore dhe të bazuara në prova. Aktualisht ai ka shumë pak mundësi për të kryer këto lloj studimesh, për shkak të mungesës së kohës dhe burimeve, por e konsideron këtë si një mangësi serioze. Vetëm në rastin e çështjeve speciale ai mbledh vetë të dhëna, p.sh. për raportin mbi viktimat nigeriane. Raporteri punon së bashku me HEUNI, institutin rajonal evropian në Rrjetin e Programit të KB për Drejtësi Penale dhe Parandalimin e Krimit, i cili funksionon nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë finlandeze si institut i pavarur kërkimi dhe krijimi politikash. Megjithatë, kjo nuk korrigjon mungesën e mjeteve për të bërë hulumtimet e veta të pavarura.

Raporteri nuk mbledh statistika. Ai nuk është një qendër informacioni statistikor, pasi ka agjenci të tjera që janë më të kualifikuara për ta bërë këtë, p.sh. Koordinatorin Kombëtar. Prioriteti i tij qëndron në analizën cilësore.

Vlera e shtuar e Raporterit Kombëtar në trafikimin e qenieve njerëzore, ndikimi dhe parakushtet

Ashtu si Raporteri holandez, ai finlandez thekson rëndësinë e një pozicioni të pavarur. Sipas Raporterit të parë, Johanna Suurpää, ky është një parakusht që një Raporteri Kombëtar të ketë vlerë të shtuar:

“...vlera e shtuar e një Raporterit qëndron në sigurimin e një analize objektive për mënyrën se si trajtohet trafikimi i qenieve njerëzore. Raporteri mund të ekspozojë problemet dhe të japë rekomandime për zgjidhjen e tyre. Raporteri mbledh të gjithë informacionin përkatës nga agjenci të ndryshme dhe eksploron metoda të reja kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

Krahas botimit të raporteve, ajo thekson se është e rëndësishme që Raporteri të krijojë një rrjet të mirë dhe të përfshijë zbatimin e legjislacionit ndërkombëtar.

Pozicioni i pavarur

Në mënyrë të ngjashme, Raporteri aktual gjithashtu e cilëson pavarësinë si një domosdoshmëri. Në raportin e tij për vitin 2014 thuhet:

“Pavarësia përforcon konfidencialitetin dhe besueshmërinë e Raporterit Kombëtar dhe aftësinë e tij për të analizuar gjendjen aktuale të veprimeve kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe për të paraqitur propozime se si mund të përmirësohet ajo, duke pasur parasysh që Raporteri është një figurë e ndarë nga struktura përgjegjëse për politikën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në qeveri.” (f. 17).

Gjithashtu, zonja Venla Roth thekson në intervistë rëndësinë e pavarësisë dhe nevojën për të ndarë rolin e Koordinatorit nga roli i Raporterit, së bashku me disa parakushte të tjera që diskutohen më poshtë.

Ndarja e funksionit të Raporterit Kombëtar dhe Koordinatorit

Monitorimi dhe koordinimi janë funksione të ndryshme dhe si të tilla duhet të ndahen, ndryshe Raporteri Kombëtar nuk mund të jetë i pavarur. Nuk është e mundur që politikën të analizohen në mënyrë kritike, për sa kohë që je pjesërisht përgjegjës për zbatimin e tyre. Një gjë e tillë do të thoshte që duhet të kritikoni punën tuaj. Raporteri duhet të jetë në gjendje të shikojë në mënyrë kritike qeverinë dhe zbatimin e politikave. Detyra e Raporterit është të monitorojë Koordinatorin Kombëtar, i cili supozohet të marrë përsipër rekomandimet e tij. Raporteri mund të marrë pjesë në takime koordinuese, por si ekspert i pavarur, jo si pjesë e degës ekzekutive.

Nga ana tjetër, zonja Roth vë në dukje se në shumë vende një pozicion i pavarur mund të jetë i vështirë për t’u arritur, pasi mund të perceptohet si e frikshme që një institucion të mos jetë nën kontrollin e qeverisë. Gjithashtu është e vështirë të jesh gjithmonë ai që kritikon, hedh gjëra të vështira për diskutim në tryezë, shtron pyetje kritike. Për më tepër, të drejtat e njeriut nuk janë shumë popullore ditët e sotme. Ndoshta, shton ajo, pavarësia nuk është më guri i themelit që duhet të shtrohet, por vazhdon të jetë diçka për të cilën duhet të përipiqemi.

E drejta për të marrë informacion të klasifikuar

Autoritetet janë të detyruara të japin informacion kur kërkohet, edhe nëse bëhet fjalë për viktime individuale. Megjithatë Raporteri finlandez nuk mbledh në mënyrë strukturore informacione mbi viktimat, ai mund të ndërhyjë në raste individuale. Në atë rast, qasja në të dhënat personale është e nevojshme.

Lidhja e drejtpërdrejtë/aksesi në parlament

Raportet duhet të diskutohen në parlament dhe në komisionet parlamentare. Sipas sistemit finlandez, gjithçka që dërgohet në parlament diskutohet atje. Kjo do të thotë që Raporteri nuk ka pse të bindë qeverinë, por parlamentin. Si pasojë, parlamenti mund të udhëzojë qeverinë. Kur raporti dhe/ose rekomandimet e Raporterit Kombëtar diskutohen në parlament, ai gjithashtu do të kërkojë mendimin e OJQ-ve dhe palëve të tjera të interesit. Pasi këta të fundit të dëgjohen, Parlamenti mund të kërkojë nga Raporteri Kombëtar informacion shtesë, deklarata ose memo.



Venla Roth

Perspektiva e trafikimit si çështje e të drejtave të njeriut: të drejtat e njeriut si parim dhe metodologji udhëzuese

Ekzistojnë shumë perspektiva mbi trafikimin e QNJ: si një problem i së drejtës penale, një problem emigracioni etj. Ndërkaq, për Raporterin Kombëtar është thelbësore të shikohet trafikimi nga një perspektivë e të drejtave të njeriut. Siç u shpreh znj. Roth:

“Kjo nuk do të thotë që ju nuk kuptoni perspektivat e tjera, por që ju shikoni në mënyrë sistematike se çfarë pasojash ka një veprim apo mosveprim i caktuar në zbatimin e të drejtave të viktimave. Të drejtat e njeriut janë pikë referimi. Baza ligjore është: A i plotëson veprimi detyrimet sipas ligjit kombëtar dhe ndërkombëtar? A është detyra jonë të bëjmë të dukshme problemet, të metat dhe mangësitë në strukturë nga këndvështrimi i viktimës? Pyetja kryesore është: Si mund t’i zbatojmë më mirë të drejtat e tyre? Të drejtat e njeriut janë gjithashtu me rëndësi parësore në zgjedhjen e problemit ku doni të përqendrohemi: çfarë është e rëndësishme për viktimat?”.

Bashkëpunim i ngushtë me aktorë të ndryshëm, përfshirë OJQ-të, policinë, etj.

Nevojitet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha palët e tjera për të marrë informacionin e duhur. Është detyrë e Raporterit Kombëtar të përkthejë atë që ndodh në terren në zgjidhje strukturore: çfarë duhet të bëjnë ata që janë në pushtet për të lehtësuar problemet në terren; për të krijuar kushtet që ata të bëjnë më mirë. Raporteri ka konsultime të rregullta me OJQ-të për ato që mendon se janë të rëndësishme. Ai përpiqet të marrë mendimin e tyre dhe t’u japë atyre një zë. E njëjta gjë vlen edhe për policinë dhe prokurorët lokalë. Siç është shprehur zonja Roth:

“Edhe ata duan të bëjnë më mirë, prandaj është e rëndësishme t’u jepni atyre një megafon, sepse ata gjithashtu punojnë në terren. Edhe ata shpesh nuk dëgjohen sa më lart të shkoni në hierarki”.

Mundësia për të bërë studime të bazuara në prova

Aktualisht, Raporteri mund ta bëjë këtë vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kur ka fonde shtesë. Kjo vlerësohet si një mangësi serioze.

Aplikimi i modelit të Raporterit Kombëtar ndaj dhunës me bazë gjinore?

Në fund, paraqitet një pyetje interesante nëse modeli i Raporterit Kombëtar do të funksiononte edhe për krime të tjera. Raporteri, p.sh., kohët e fundit propozoi të krijojë një Raporter Kombëtar për dhunën me bazë gjinore si rekomandim në raportimin e tij në GREVIO, komiteti mbikëqyrës për Konventën e CoE mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

5. Belgjika⁸

Që nga Shtatori i 2014, Myria, Qendra Federale e Migracionit, është komponenti i pavarur i mekanizmit të Raporterit Kombëtar kundër Trafikimit të QNJ, krahas Njësisë së Koordinimit Ndërsektorial për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (ICU), e cila raporton në emër të shtetit belg. Deri në vitin 2014, Myria shërbeu de facto si Raporter Kombëtar.

Myria trashëgoi kompetencat e saj nga paraardhësi, Qendra për Mundësi të Barabarta dhe Luftë ndaj Racizmit (CGK). Në vitin 2014, kjo e fundit u nda në Qendrën Ndër-Federale për Mundësi të Barabarta (UNIA) dhe Myria, Qendrën Federale e Migracionit. Të dy organizatat ende kanë kontakte të ngushta dhe kanë anëtarë të përbashkët të Bordit të Drejtorëve.

Historia e Qendrës për Mundësi të Barabarta e ka zanafillën në vitet 90' kur një Komision Parlamentar rekomandoi ndërtimin e një strukture të veçantë për viktimat e trafikimit, reformimin e legjislacionit dhe krijimin e një organizate për të monitoruar dhe vlerësuar luftën kundër trafikimit. Kjo çoi në krijimin e Qendrës për Mundësi të Barabarta në 1995. Një nga detyrat e saj ishte të stimulonte luftën kundër trafikimit, të koordinonte aktivitetet kundër tij dhe të siguronte bashkëpunim të mirë midis tre qendrave të specializuara kundër trafikimit, me qëllim harmonizimin e praktikave. Mjeti kryesor që përdorte ishte nxjerrja e raporteve vjetore të pavarura të vlerësimit mbi zhvillimet dhe rezultatet e luftës kundër trafikimit. Përveç kësaj, ai mund të fillonte procedurat ligjore në emër të viktimave të trafikimit ose në emrin e vet.

Myria, Qendra Federale e Migracionit, si Raporter Kombëtar

Instituti i Raporterit Kombëtar në Belgjikë ka një strukturë me dy krerë. Funkzioni është i ndarë në dy organe që plotësojnë njeri-tjetrin:

- Njësia e Koordinimit Ndërsektorial për Luftën kundër Trafikimit të qenieve njerëzore (ICU), e cila është përgjegjëse për koordinimin dhe harmonizimin e aktiviteteve të të gjitha departamenteve të përfshira dhe për vlerësimin e tyre.
- Myria, Qendra Federale e Migracionit, e cila si Raporter i Pavarur Kombëtar vlerëson politikat kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

ICP raporton në emër të shtetit dhe lëshon raporte dy-vjeçare mbi zbatimin e ligjit dhe aktivitetet e ministrive përgjegjëse. Ky organ mblidhet dy herë në vit. Brenda ICP, shërbimi publik federal i Drejtësisë, presidenti i Byrosë, është përgjegjës për hartimin e raportit dy-vjeçar të qeverisë. Megjithatë, detyra kryesore e ICP është koordinimi dhe prezantimi i një politike.

Myria është një institucion publik i pavarur, i themeluar nga Akti i Parlamentit në 1993 (rishikuar në 2013). Ajo ka tre detyra plotësuese ligjore: mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve të huaj, sigurimin e informacionit mbi natyrën dhe shkallën e flukseve të migrimit dhe stimulimin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Myria u përrua

8 Burimet: Intervistë me Znj. Patricia Le Cocq, Raportere Kombëtare, 28 qershor 2018; Uebfaqja e Myria <http://www.myria.be/en>; faqja e internetit e KE https://ec.europa.eu/anti-trafficking/national-rapporteurs/belgium_en; Myria, Raporti Vjetor 2017 i trafikimit dhe kontrabandës së qenieve njerëzore, <http://www.myria.be/en/publications/2017-annual-report-trafficking-and-smuggling-of-human-beings-online>.

zyrtarisht në 15 Mars 2014. Që nga Gushti 2014, ajo ka një Bord Drejtorësh, i cili emërohet nga Parlamenti Federal. Drejtori i parë u emërua në 15 Mars 2015. Myria është anëtare e ENNHRI, Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut.

Mandati

Myria u emërua zyrtarisht si Raporter Kombëtar i pavarur me Dekretin Mbretëror të 21 Korrikut 2014 (në fuqi që nga Shtatori 2014), së bashku me Njësinë e Koordinimit Ndërsektoriale (ICU). Ajo merr pjesë në ICU, së bashku me përfaqësues të Komuniteteve dhe Rajoneve, Agjencinë për Hetime Financiare/pastrim parash dhe përfaqësues të tre strehëzave të specializuara për persona të trafikuar, Payoke, Sürya dhe PAGASA. Si Myria, ashtu edhe ICU përfaqësohen në takimet e Rrjetit Evropian të Raporterëve Kombëtarë të Trafikimit të Qenieve Njerëzore.



Princeshat e Emirateve të Bashkuara Arabe duke shkuar në gjyq në Belgjikë

Që nga viti 1996, Myria (dhe paraardhësi i saj CGK) boton raporte vjetore të pavarura vlerësimi mbi politikat kundër trafikimit dhe rezultatet në luftën kundër tij. Ajo punon ngushtë së bashku me tre qendrat e specializuara të pritjes për viktimat e trafikimit. Ajo mund t'u japë informacion emigrantëve në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre, por gjithashtu mund të qaset nga viktimat e mundshme të trafikimit, të cilat zakonisht i referohen një prej qendrave të specializuara.

Pavarësisht se mandati i saj përfshin kryesisht emigrantët, puna e Myria mbulon edhe viktimat belge të trafikimit. Ky nuk ka qenë kurrë një problem. Ajo gjithashtu mund të japë rekomandime për viktimat kombëtare, p.sh. në lidhje me personat që mashtrojnë përmes premtimeve për martesë. Për më tepër, ajo jep rekomandime për Komunitetet, edhe pse është një organ federal. Krahas rolit të saj si mekanizëm i pavarur monitorimi, Myria është e autorizuar të ndërmarrë veprime ligjore dhe të ngrejë padi civile në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore (Ligj i 13 Prillit 1995). Myria gjithashtu mund të ndërhyjë në rast ankesash ose në raste vazhduese me interes strategjik, në të cilat shkelen të drejtat themelore. Një shembull është rasti i shfrytëzimit të punëtorëve shtëpiake nga një princeshë e Emirateve të Bashkuara Arabe dhe vajzat e saj, në të cilën 14 nga viktimat, qendrat e specializuara dhe Myria vepruan si palë në procesin civil⁹. Princeshat u dënuan për trafik të QNJ dhe trajtim degradues të shërbëtorëve të tyre nga një gjykatë në Bruksel.

Myria mund të përdorë jurisprudencën edhe në rastet kur viktimat nuk bashkohet si palë civile për të përfaqësuar aspektin humanitar. Fuqia për të ndërmarrë veprime ligjore lejon që Myria të ndajë ekspertizën e saj me gjyqësorin dhe aktorët e tjerë të interesuar, të mbledhë shembuj të praktikave të mira apo të këqija dhe të mbështesë rastet provuese. Kjo fuqi i lejon edhe qasje në të dhëna konfidenciale, të cilat nuk mund t'i

⁹ Shih: <https://www.dw.com/en/eight-arab-princesses-go-on-trial-in-belgium/a-38796246>: BBC, 23 qershor 2017, princeshat e Emirateve të Bashkuara Arabe fajtores për abuzimin e shërbëtorëve në Belgjikë <https://www.bbc.com/news/world-europe-40380071>; Myria (2017), Trafikimi i qenieve njerëzore nuk duhet të mbetet pa u ndëshkuar, <http://www.myria.be/en/publications/dossier-of-emirati-princesses-trafficking-in-human-beings-should-not-go-unpunished>.

kenë në mënyrë tjetër dhe të marrin njohuri të thelluara mbi trajtimin e një çështjeje dhe trajtimin e viktimave. Kjo lidhet shpesh me raste afatgjata dhe të komplikuar. Myria ka trajtuar rreth 20 raste në vit. Megjithatë, vitet e fundit, ky numër është ulur për shkak të shkurtimeve financiare. Në 2016 Myria nisi procedurat civile në shtatë çështje të reja, pesë prej të cilave përfshinin trafikimin e qenieve njerëzore dhe dy kontrabandë njerëzish. Si Myria, ashtu edhe qendrat e specializuara kanë fuqinë të veprojnë si palë civile në emër të viktimave ose në emrin e tyre.

Bashkëpunimi me OJQ-të

Myria punon ngushtë së bashku me tre qendrat e specializuara / strehëzat. Formalisht ata janë përgjegjës për bashkëpunim të mirë midis tre strehëzave të specializuara. Myria është gjithashtu në bordin e njërës prej tyre. Kjo është trashëguar nga Qendra për Mundësi të Barabarta (CGK), e cila ishte përfshirë në themelimin e dy strehëzave të para.

Një nga projektet në vazhdim që Myria po zhvillon me strehëzat, është krijimi i një *data baze* (anonime) për viktimat, e cila do të bënte të mundur krahasimin e të dhënave. Qendrat e specializuara janë gjithashtu një burim informacioni. Për shembull, atyre u kërkohet të dërgojnë vendime gjyqësore të ndryshme në Myria, me qëllim analizimin e jurisprudencës. Ndonjëherë Myria-s i kërkohet të veprojë si palë civile nga ana e qendrave.

Palët takohen dy herë në vit për të diskutuar gjendjen e çështjeve dhe pengesat e hasura. Të tre qendrat nga ana e tyre kanë kontakt të ngushtë me OJQ-të e tjera në terren, si për shembull me OJQ-të që punojnë me punëtorët e seksit.

Stafi dhe financimi

Myria ka një staf prej rreth 15-20 personash, nga të cilët dy punojnë me kohë të plotë për çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore. Në disa raste ata mbështeten nga dy kolegë, p.sh. për qëllimet e raporteve vjetore.

Ata subvencionohen nga qeveria dhe lotaria kombëtare. Për të siguruar pavarësinë e tyre, kërkojnë të financohen nga linja buxhetore parlamentare, ashtu si Kolegji i Ombudsmanëve Federalë. Megjithatë, që nga viti 2015, ata po përballen me shkurtime serioze, pavarësisht se ligji supozohet të garantojë pavarësinë e institucionit me anë të fondeve fikse. Myria e konsideron këtë një problem serioz, pasi roli i tyre si një reporter i pavarur kombëtar lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e tyre për të vepruar në pavarësi të plotë financiare (Raporti Vjetor 2016, f. 6).

Raportet

Myria harton raporte vjetore, duke siguruar një pasqyrë të pavarur dhe kritike të rezultateve dhe zhvillimeve në luftën kundër trafikimit dhe kontrabandës. Raportet janë publike dhe mund të gjenden në faqen e internetit të Myria: <http://www.myria.be/en>. Komponentët e fiksuar janë zhvillimet aktuale në kornizën ligjore dhe atë të politikave; analiza e rasteve në të cilat ajo ka vepruar si palë civile; pasqyra e jurisprudencës; shifrat kryesore, statistikat dhe rekomandimet.

Ndërsa raportet dy-vjeçare të ICU-së përshkruajnë aktivitetet e ndërmarra nga ministri të ndryshme në fushën e parandalimit etj., dhe përqendrohen në të dhëna dhe statistika sasiore, Myria fokusohet më shumë në një analizë thelbësore dhe cilësore të të dhënave. Çdo vit raporti adreson një çështje specifike. Raporti i fundit, p.sh., diskutoi rolin e internetit dhe mediave sociale në trafikimin dhe kontrabandën e QNJ (2017). Raportet e mëparshme analizuan p.sh. shfrytëzimin për lypje (Raporti Vjetor 2016), martesat e hershme dhe të detyruara dhe viktimat e premtimeve false për martesë (Raporti Vjetor 2015) si dhe paratë e përfitimet e tjera nga shfrytëzimi i viktimave të trafikimit dhe kontrabandës së qenieve njerëzore (Raporti Vjetor 2011).

Myria formulon rekomandime për politikëbërësit dhe palët e tjera të interesit, duke synuar që ato të miratohen nga ICU. Raportet e saj vjetore i drejtohen qeverisë, por edhe parlamentit dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Mbledhja e të dhënave dhe e drejta për të marrë informacion

Myria mund të kërkojë nga të gjitha palët e interesuara të japin të dhëna, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë dhe Çështjeve të Migracionit, Inspektoratet, qendrat e specializuara etj.

Sipas Raportit Vjetor 2016, shumica e punës së saj statistikore dhe rekomanduese është e mundur vetëm në sajë të kontakteve dhe marrëdhënieve që ajo mban me autoritete të shumta publike, veçanërisht me Zyrën e Emigracionit, Zyrën e Komisionerit të Përgjithshëm për Refugjatët dhe Personat Pa Shtetësi, Fedasil, Shërbimin Publik Federal të Punëve të Brendshme, Drejtësisë, Punëve të Jashtme dhe Punësimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Statistikave dhe Këshillin për Çështjet Ligjore për të Huajt.

Myria nuk ka qasje në të dhëna konfidenciale, përveçse si palë civile në çështjet gjyqësore. Kjo ndihet si një mangësi. Ajo nuk mbledh të dhëna personale të viktimave, por mbledh të dhënat personale të emigrantëve që i drejtohen me pyetje mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Vlera e shtuar e një Raporteri Kombëtar kundër trafikimit, ndikimi dhe parakushtet

E pyetur për ndikimin e Raporteve Vjetore dhe punën e Raporterit Kombëtar, Znj. Patricia Le Cocq, Raportere Kombëtare nga Myria, sheh tre efekte kryesore. *Në radhë të parë*, rekomandimet e Myria-s gjejnë rrugën e tyre në Planin Kombëtar të Veprimit të qeverisë. Një shembull është rekomandimi për rëndësinë e hetimeve financiare. *Së dyti*, rritet ndërgjegjësimi për çështje specifike, p.sh. zbatimi i dispozitës së mosndëshkimit dhe shfrytëzimit përmes lypjes. *Së treti*, ndikon në mënyrën se si trajtohet trafikimi në praktikë. Një shembull është luftimi i shfrytëzimit për punë, ku Raporteri Kombëtar solli në vëmendje abuzimin e sistemit të punëtorëve me shërbim dhe stimuloi përdorimin e mediave sociale si mjet hetimi.

Ndarja midis Koordinatorit Kombëtar dhe Raporterit Kombëtar

Si parakusht kritik, ajo përmend ndarjen midis Raporterit Kombëtar dhe Koordinatorit Kombëtar. Koordinimi nuk është i njëjtë me monitorimin apo vlerësimin dhe është mirë që ato të ndahen.

Pavarësia

Një parakusht i dytë i rëndësishëm është pavarësia, në kuptimin e hapësirës për monitorim të pavarur dhe një qasje kritike. Për shembull, vihet në dukje se Shërbimi Federal i Prokurorisë dështoi të marrë përgjegjësinë e tij për koordinimin e hetimeve ndërkombëtare për trafikimin. Nëse do të ishin pjesë e Ministrisë do të ishte e vështirë të thuhej kjo. Pavarësia është gjithashtu e rëndësishme për të qenë në gjendje të komunikojmë me të gjitha palët e përfshira: autoritetet publike, institucionet, OJQ-të, grupet e interesit, partitë politike, qendrat kërkimore dhe qytetarët.

Akresi tek palët përkatëse, mandati i gjerë, autoriteti, financimi i sigurt

Parakushte të tjera janë qasja dhe kontakti me aktorët përkatës mbi baza të barabarta; mundësia për të vlerësuar politikën në të gjitha nivelet; dhe veshja me autoritet, si kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Për më tepër, financimi duhet të jetë i sigurt, përndryshe nuk është e mundur të ndërtohet përvoja dhe statusi. Një status i sigurt financiar është gjithashtu i rëndësishëm për të siguruar pavarësinë.

6. Portugalia¹⁰

Në janar 2008, një Koordinator Kombëtar u emërua nga Komisioni për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore (CIG) për të koordinuar veprimet kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Në të njëjtin vit, Koordinatori Kombëtar u emërua si Raporter Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore sipas Planit të parë Kombëtar të Veprimit. Krahas Raporterit Kombëtar, Observatori për Trafikimin e Qenieve Njerëzore është i mandatuar të prodhojë, mbledhë, analizojë dhe shpërndajë informacion mbi trafikimin e personave dhe llojet e tjera të dhunës gjinore.

Koordinatori Kombëtar si Raporter Kombëtar

Koordinatori/Raporteri Kombëtar është përgjegjës për koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit. Monitorimi dhe vlerësimi bëhen në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë palët e interesit qeveritare dhe jo-qeveritare. Koordinator/Raporteri përpilon raporte vjetore mbi zbatimin e Planit të Veprimit, të cilat i paraqiten Sekretarit të Shtetit. Ai gjithashtu mund të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa të reja legjislative për luftimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të tij. Në fund të një periudhe të mbuluar nga Plani i Veprimit, Koordinator / Raporteri është përgjegjës për të organizuar një vlerësim të pavarur të zbatimit të tij nga një vlerësues i jashtëm. Raporteri punon ngushtë së bashku me Observatorin, i cili është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave për trafikimin e qenieve njerëzore.

Mandati

Raporteri Kombëtar është pjesë e Komisionit për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore (CIG). CIG i përket administratës publike. Ai është pjesë e Presidencës së Këshillit të Ministrave

¹⁰ Burimet: Intervistë me Manuel Albano, Koordinator Kombëtar dhe Raporter për Trafikimin e Qenieve Njerëzore, 25 qershor 2018; Uebfaqja e KE https://ec.europa.eu/anti-trafficking/national-rapporteurs/portugal_en; faqja në internet e Komisionit për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore <https://www.cig.gov.pt/planos-nacionais-areas/trafico-deseres-humanos/>; faqja në internet e Observatorit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore <http://www.otsh.mai.gov.pt/en/Pages/default.aspx>.

dhe nën autoritetin e Sekretarit të Shtetit për Shtetësinë dhe Barazinë. Ai ka një mandat të gjerë mbi dhunën gjinore dhe vlerëson zbatimin e disa planeve të veprimit, ndër të cilat Plani Kombëtar i Veprimit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Sidoqoftë, çështja e vetme për të cilën ai vetë mbledh dhe analizon të dhëna, është trafikimi. CIG është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve, siç përcaktohet në Planin Kombëtar të Veprimit.

Koordinatori / Raporteri Kombëtar është përgjegjës për:

- ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit nga subjektet e ndryshme përgjegjëse;
- hartimin e raporteve vjetore për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit dhe raportimin pranë Qeverisë në përputhje me rrethanat;
- vlerësimin përfundimtar të zbatimit të Planit të Veprimit nga një entitet i jashtëm;
- promovimin e projekteve kërkimore që mund të kontribuojnë për një kuptim më të mirë të trafikimit;
- sigurimin e informacionit, kur kërkohet, mbi masat legislative në lidhje me luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave;
- vendosjen e kontakteve me subjektet homologe dhe ndërkombëtare në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore;
- promovimin dhe marrjen pjesë në zhvillimin e rrjeteve dhe strukturave kombëtare e ndërkombëtare të informacionit.

Një pjesë e rëndësishme e mandatit është ndërtimi i një rrjeti gjithëpërfshirës dhe besimi midis të gjitha palëve përkatëse. Është detyra e Koordinatorit / Raporterit Kombëtar të koordinojë të gjithë partnerët e rrjetit, në lidhje me zbatimin dhe vlerësimin e Planit të Veprimit, përfshirë zbatimin e traktateve ndërkombëtare (p.sh. Konventa e KE kundër Trafikimit). Për këtë qëllim ekziston një Grup Pune i Brendshëm, i cili përbëhet nga të gjithë partnerët qeveritarë që merren me trafikimin dhe tre OJQ të zgjedhura. Këto të fundit përfaqësojnë të gjitha OJQ-të e përfshira dhe veprojnë si lidhje ndërmjet Koordinatorit / Raporterit Kombëtar dhe shoqërisë civile. Pranë Grupit të Punës ekziston një Rrjet i shërbimeve mbështetëse për viktimat e trafikimit, i cili përbëhet nga të gjitha OJQ-të përkatëse dhe institucionet qeveritare.

Të dyja organet janë të përfshira në përpilimin e raporteve vjetore, por edhe në zhvillimin e fushatave dhe veprimtarive të tjera. Një shembull është krijimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Dokumenti i parë u hartua nga Koordinatori / Raporteri Kombëtar, Grupi i Punës dhe Observatori dhe më pas u diskutua nga Rrjeti, Policia, Prokuroria, etj. Bazuar në komentet e tyre u adoptua propozimi, i cili përmirësoi MKR dhe, krijoi një ndjenjë të pronësisë së përbashkët. Grupit të Punës dhe Rrjetit gjithashtu, u kërkohet mendimi dhe përvoja e tyre, p.sh. për përpilimin e raporteve për GRETA mbi zbatimin e Konventës së KE kundër Trafikimit. Palët e interesuara, qeveritare dhe jo-qeveritare, mund të thërrasin Koordinatorin / Raporterin Kombëtar në rast problemesh ose vështirësish, për të ndihmuar në zgjidhjen e tyre, p.sh. në lidhje me qasjen në të dhëna.

Mbledhja e të dhënave për trafikimin e QNJ nuk është tagër i Raporterit Kombëtar, por i Observatorit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (OTSH). Observatori u krijua gjithashtu në 2008 (Dekret-Ligj nr. 229/2008 i 27 Nëntorit). Ai është vendosur nën Ministrinë e

Brendshme dhe është pjesë e Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Misioni i tij është të kontribuojë në analizën, njohuritë dhe ndërhyrjet mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe format e tjera të dhunës gjinore. Detyrat e tij kryesore janë prodhimi dhe mbledhja e informacioneve mbi trafikimin njerëzor dhe format e tjera të dhunës gjinore; promovimi i zhvillimit të aplikacioneve softuerike për të mbështetur mbledhjen e informacionit; dhe mbështetja e vendimeve politike në fushat e tij të kompetencës në rast se kërkohet.

Stafi dhe financimi

Koordinatori / Raporteri Kombëtar mbështetet nga dy anëtarë të stafit të Komisionit për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore. Sidoqoftë, ata nuk punojnë ekskluzivisht me trafikimin, duke qenë se ky i fundit është pjesë e një mandati më të gjerë të CIG për çështjet gjinore. Observatori ka dy anëtarë të stafit që punojnë me trafikimin.

Raportet

Në funksionin e tij të Raporterit, Koordinatori Kombëtar nxjerr raporte vjetore vlerësimi mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit. Për përpilimin e këtyre raporteve, ai shpërndan pyetësorë tek të gjitha palët e përfshira, si OJQ-të, organet ligj zbatuese, etj. Ai nuk mbledh të dhëna personale të viktimave. Përpara se të dërgohen raportet, ato aprovohen / akreditoohen nga të gjithë partnerët përkatës qeveritarë dhe joqeveritarë.

Raportet i dorëzohen Sekretarit të Shtetit për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore, i vendosur në Presidiumin e Këshillit të Ministrave. Ato janë publike dhe i paraqiten Parlamentit nga Sekretari i Shtetit. Në fund të periudhës së veprimit, krahas raporteve vjetore, kryhet një vlerësim përfundimtar nga një vlerësues i jashtëm. Më tej, Koordinatori / Raporteri mund të hartojë raporte tematike.

Mbledhja e të dhënave

Raporteri bashkëpunon ngushtë me Observatorin për Trafikimin e Qenieve Njerëzore (OTSH), i cili është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave për trafikimin. Përveç kësaj, ai mban kontakte të ngushta me universitetet, të cilat ofrojnë mundësi për kërkim shkencor.

OTSH është entiteti përgjegjës për sistemin kombëtar të monitorimit. Ai mbledh dhe analizon të dhëna sasiore dhe cilësore nga organet e ndryshme, në mënyrë që të gjenerojë njohuri mbi trafikimin dhe dinamikën e tij kriminale dhe sociale. Rezultatet u vihen në dispozicion të gjitha palëve të interesuara, përfshirë agjencive të zbatimit të ligjit dhe OJQ-ve. Qëllimi përfundimtar është të kontribuojë në politika dhe praktika më të mira për parandalimin dhe procedimin penal të trafikimit, si dhe në mbrojtjen e viktimave.

Observatori mbledh të dhëna për të gjitha fazat e identifikimit të viktimave të mundshme. Të dhënat kanë të bëjnë me procesin e rekrutimit, format e shfrytëzimit, statistikën për rekrutuesit, etj. Ai gjithashtu mbledh të dhëna për viktimat portugeze jashtë vendit, por nuk grumbullon të dhëna personale të viktimave.

Të gjitha palët e interesuara janë të detyruara të dërgojnë të dhënat e tyre në Observator, qëllim për të cilin ka memorandume të mirëkuptimit me policinë, OJQ-të, etj. Observatori harton raporte të brendshme 3-mujore dhe raporte vjetore publike. Për shembull,

Observatori koordinoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve të Brendshme (Ministria e Punëve të Brendshme) Projektin Evropian “Drejt një monitorimi pan-evropian të trafikimit të qenieve njerëzore”. Qëllimi ishte krijimi i një modeli të përbashkët evropian të monitorimit.

Vlera e shtuar e një Raporterit Kombëtar kundër trafikimit, ndikimi dhe parakushtet

I pyetur për ndikimin e punës së tij, z. Albano vëren se zakonisht rekomandimet e tij pranohen nga qeveria edhe kur ato janë të diskutueshme dhe pa marrë parasysh ngjyrën politike të qeverisë. Shembuj janë rekomandimi për një fond të veçantë për OJQ-të për të ndihmuar viktimat të kthehen dhe për të rritur financimin e strehëzave. Sipas këndvështrimit të tij, një nga arsytet e rëndësishme të pranimit është se ato nuk janë ‘thjesht’ rekomandime të Raporterit Kombëtar, por bazohen në prova dhe mbështeten gjerësisht nga të gjithë palët e përfshira.

Ndikimi politik dhe bashkëpunimi shumë sektorial me OJQ-të

Si parakushte që një Raporter Kombëtar të jetë efektiv, ai përmend tre parime:

- Raporterit duhet të pozicionohet në një nivel ku ai/ ajo të ketë ndikim në vendimet e politikave
- Raporterit duhet të ketë një pozicion që tejkalon një sektor ose perspektivë të vetme. Për të qenë efektiv nevojitet një vizion multi-disiplinor dhe ndër-sektorial, përfshirë shëndetin, migracionin, krimin, të drejtat e njeriut, etj.
- Duhet të sigurohet ndikimi dhe bashkëpunimi i OJQ-ve. Ato njohin fushën, punojnë me viktimat dhe i dinë nevojat e tyre.

Qasja ndaj të drejtave të njeriut

Mandati duhet të jetë për viktimat, për të krijuar mjedisin më të favorshëm për to:

“Problemi nuk është çështje migrimi. Problemi janë viktimat. Nëse vendos kufijtë si parësore, ti dështon të mbrosh viktimën”.

Çështja e pavarësisë

Sa i përket nevojës për një pozicion të pavarur të Raporterit Kombëtar, ai vëren se, pavarësia lidhet gjithashtu me nivelin e demokracisë dhe mënyrën e zhvillimit të rekomandimeve. Raportet dhe rekomandimet janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët përkatës. Ato paraqiten në Parlament dhe janë të hapura për kritikë nga të gjithë. Megjithatë, ai pajtohet p.sh., me Raporterin Holandez, se është e rëndësishme që Raporterit të mos jetë i mbyllur në një “pozicion të ngurtë”, por mund t’u përgjigjet nevojave dhe zhvillimeve të fushës dhe të jetë i lirë të vendosë për çështjet që ai ose ajo dëshiron të hetojë.



Nuk ka vetëm një model të mirë

Së fundmi, ai thekson se nuk ka vetëm 'një model të mirë'. Secili vend është i ndryshëm dhe duhet të gjendet modeli që përshtatet më mirë me kontekstin kombëtar.

7. Konkluzione dhe Rekomandime

Vetëm disa vende të BE-së kanë krijuar një Raporter Kombëtar në kuptimin e ngushtë, ndërsa shumica e vendeve anëtare vendosën për një 'mekanizëm ekuivalent'. Në shtatë vende, Koordinatori Kombëtar përmbush funksionin e Raporterit Kombëtar (Kroacia, Estonia, Greqia, Hungaria, Letonia, Portugalia, Republika Çeke). Në tetë vende, funksioni i Raporterit Kombëtar përmbushet nga një organ qeveritar (Itali, Lituani, Maltë, Poloni, Rumani, Sllovakia, Spanjë, Suedi).

Në shumicën e vendeve, (funksioni) i Raporterit Kombëtar është vendosur nën Ministrinë e Brendshme (9: Hungaria; Letonia; Republika Çeke; Lituania; Malta; Polonia; Rumania; Sllovakia; Spanja). Ministrinë e tjera janë Ministria e Punëve të Jashtme (Greqia) dhe Ministria e Drejtësisë / Policia (2: Estonia; Suedia).

Duke parë pozicionimin e Raporterit Kombëtar, fokusi kryesor është në trafikimin ndërkufitar dhe atw tw qenieve njerëzore, si një vepër penale / sigurie dhe më pak në trafikimin e brendshëm dhe si shkelje të drejtave të njeriut. Vetëm në tre vende, Raporteri Kombëtar është i vendosur brenda një organi për të drejtat e njeriut dhe / ose mundësi të barabarta, respektivisht Zyra Qeveritare për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Pakicave Kombëtare (Kroaci); Komisioni për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore (Portugali); dhe Departamenti i Shanseve të Barabarta (Itali).

Në katër shtete, funksioni i Raporterit Kombëtar ushtrohet nga një organ i pavarur. Në të gjitha rastet kemi të bëjmë me një organ të bazuar në të drejtat e njeriut, i cili varion nga Instituti Kombëtar i të Drejtave të Njeriut (Francë, Luksemburg) në Qendrën Federale të Migracionit (Belgjikë) dhe Ombudsmanin e Mos-Diskriminimit (Finlandë). Vetëm një shtet krijoi Zyrë të veçantë të pavarur si Raporter (Holandë).

Tetë shtete nuk caktuan një Raporter Kombëtar (Austri, Bullgari, Qipro, Danimarkë, Gjermani, Irlandë, Slloveni, MB).

Parakushtet për funksionimin efektiv të një Raporterit Kombëtar

Për këtë studim, u intervistuan Raporterët Kombëtarë të Holandës, Finlandës, Belgjikës dhe Portugalisë. Të katër vendet vendosën për një model të ndryshëm. Në Holandë, Raporteri Kombëtar ka zyrën e tij/saj. Në Finlandë, Raporteri Kombëtar është pjesë e Avokatit të Popullit për Minoritetet. Në Belgjikë, funksioni i Raporterit përmbushet nga Myria, Qendra Federale e Migracionit. Në Portugali, Koordinatori Kombëtar përmbush rolin e Raporterit Kombëtar nën Komisionin për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore.

Një nga pyetjet që iu drejtuan të katër raporterëve lidheshin me parakushtet për funksionimin efektiv të një Raporterit kombëtar. Ata kryesisht, ranë dakord për karakteristikat e mëposhtme:

Pozita e pavarur: Pavarësia përmendet në kuptime të ndryshme. Në radhë të parë, ajo i referohet nevojës që një Raporter Kombëtar të ketë lirinë për të vendosur në mënyrë të pavarur për çështjet që ai / ajo dëshiron të hetojë. Ky është një kusht i rëndësishëm për të qenë në gjendje t'u përgjigjet zhvillimeve në terren dhe nevojave të palëve të interesuara.

Së dyti, kjo do të thotë që raporterit duhet të jetë në gjendje të shqyrtojë në mënyrë kritike politikën e qeverisë dhe zbatimin e tyre. Sipas tre prej Raporterëve të intervistuar, kjo nënkupton që funksioni i Raporterit Kombëtar duhet të ndahet nga ai i Koordinatorit Kombëtar, pasi nuk është e mundur të analizohen në mënyrë kritike politikën e qeverisë kur ai është pjesërisht përgjegjës për zbatimin e tyre. Kjo do të thoshte që ai duhet të kritikonte punën e tij. Megjithatë, Raporteri Portuguez nuk pajtohet me këtë këndvështrim. Sipas tij, pavarësia ka të bëjë kryesisht me mënyrën se si zhvillohen rekomandimet dhe faktin që raportet dhe rekomandimet paraqiten në parlament, të hapura për kritikë. Ai pajtohet me faktin që Raporteri nuk duhet të vihet në një pozicion të ngurtë dhe duhet të ketë fleksibilitetin dhe lirinë për të zhvilluar hulumtimin e tij në varësi të zhvillimeve dhe nevojave.

Së treti u theksua se pavarësia është e rëndësishme në mënyrë që Raporteri të jetë në gjendje të komunikojë me palë të ndryshme të interesuara: autoritetet publike, institucionet, institutet kërkimore, partitë politike, grupet e interesit, OJQ-të, qytetarët, etj. Pavarësia kontribuon në konfidencialitetin dhe besueshmërinë e këtij organi.

Megjithëse ata ranë dakord që Raporteri Kombëtar, sipas preferencës, duhet të jetë një organ i pavarur, në të njëjtën kohë pranuan që kjo gjë varet edhe nga konteksti kombëtar dhe ajo çfarë është e mundshme në atë kuadër. Për më tepër, u përmend që të qenit pjesë e një ministrie mund të ketë edhe përparësi, p.sh. në drejtim të lehtësimit të qasjes në të dhëna.

Qasja tek autoritetet / ndikimi politik: Raporteri duhet të ketë njëfarë distance nga qeveria, por në të njëjtën kohë të jetë në një pozitë ku ai ose ajo mund të ushtrojë ndikim në vendimet e politikës. Kjo do të thotë që Raporteri duhet të ketë kontakte të vendosura mirë me autoritetet dhe / ose qasje ndaj personave të lartë në hierarkinë qeveritare mbi baza barazie.

Autoriteti personal: Raporteri duhet të jetë dikush me autoritet personal të mjaftueshëm për të qenë në gjendje të jetë kritik (pa rrezikuar pozicionin e saj ose të tij) dhe të dëgjohet.

Baza ligjore dhe mandati i gjerë: Pozicioni i Raporterit duhet të përcaktohet në ligj, duke përfshirë rregullimin e qasjes në të dhëna dhe autoritetin për të vlerësuar politikën në të gjitha nivelet. Ky i fundit duhet të përfshijë vlerësimin e pajtueshmërisë me legjislativonin ndërkombëtar. Më e mira është pasja e një mandati të gjerë që lejon fleksibilitet dhe përgjigje ndaj zhvillimeve të reja.

E drejta për të marrë informacion / qasja në të dhëna: Raporteri duhet të ketë qasje në të dhëna, përfshirë të dhënat e klasifikuara dhe ato personale / të ndjeshme në kushte të caktuara dhe për qëllime specifike. Sigurimi i të dhënave nga palët përkatëse të interesit duhet të rregullohet me ligj.

Pozicion që tejkalon një sektor apo perspektivë të vetme: Raporteri duhet të ketë një pozicion që mundëson një qasje multi-disiplinore dhe ndër-sektoriale. Kjo lejon trajtimin e trafikimit nga këndvështrime të ndryshme, të drejtat e njeriut, krimi, migracioni, shëndetësia, etj.

Të drejtat e njeriut si parim udhëheqës: Të katër raporterët, në shkallë të ndryshme, theksojnë nevojën e marrjes së një qasjeje nga të drejtat e njeriut dhe vënien e viktimave në qendër të vëmendjes. Siç është shprehur nga Znj. Roth, kjo nuk do të thotë që të anashkalohet policia ose institucionet e tjera, por që të shikohen në mënyrë sistematike pasojat e një veprimi ose mos veprimi të caktuar për zbatimin e të drejtave të viktimave.

Bashkëpunim i ngushtë me të gjitha palët, përfshirë OJQ-të, policinë, ministrinë, etj.: Raporteri duhet të ketë qasje në të gjitha palët e përfshira. Ai ose ajo duhet të veprojë si urë lidhëse ndërmjet departamenteve përkatëse dhe midis organeve qeveritare dhe lëmit të OJQ-ve / shoqërisë civile. Në të njëjtën mënyrë, u theksua nevoja për ndërtimin e një rrjeti të fortë. Nevojitet një bashkëpunim i ngushtë për të marrë informacion, për të ditur se çfarë ndodh në terren dhe për t'u dhënë një zë atyre që punojnë në terren. Kjo vlen për OJQ-të dhe ofruesit e shërbimeve, por gjithashtu edhe për policinë.

Bashkëpunimi me OJQ-të: Të katër raporterët theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit me OJQ-të pasi ato njohin fushën, punojnë me viktimat dhe dinë nevojat e tyre. Siç u tha nga Raporteri Finlandez: *“...për të ditur me të vërtetë se çfarë ndodh në terren në lidhje me viktimat dhe në sistem, informacioni nga niveli bazë është thelbësor...”*. Raporterët qëndrojnë në kontakt të ngushtë me OJQ-të përmes takimeve, diskutimeve, konsultimeve të rregullta dhe grupeve të përbashkëta të punës. Bashkëpunimi mund të marrë forma të ndryshme. Në Finlandë, Raporteri mund të mbështesë OJQ-të (dhe zyrtarët) të angazhuar në ofrimin e ndihmës për viktimat. Në Portugali, Raporteri punon ngushtë së bashku me OJQ-të në zhvillimin e fushatave kombëtare dhe përpilimin e raporteve vjetore, ndërsa në Holandë OJQ-ja CoMensha luan një rol kryesor në mbledhjen e të dhënave në lidhje me viktimat (e mundshme). Në Belgjikë, Raporteri punon ngushtë së bashku me tre qendrat / strehëzat e specializuara për personat e trafikuar, të cilat nga ana e tyre janë në kontakt të ngushtë me OJQ-të e fushës. Raporteri Holandez gjithashtu thekson rëndësinë e një shoqërie civile të zhvilluar mirë, ndryshe Raporteri mbetet vetëm një zgjatim i qeverisë.

Financim i mjaftueshëm dhe i sigurt: Është e udhës që Raporteri të financohet nga një linjë buxhetore fikse dhe ‘e pavarur’ për të siguruar pavarësinë dhe vazhdimësinë e tij financiare. Financimi duhet të jetë i sigurt, në mënyrë që të krijojë përvojë dhe status, si dhe i mjaftueshëm, në mënyrë që Raporteri të jetë në gjendje të kryejë hulumtimet e tij.

Përgjegjësi përpara qeverisë apo parlamentit? Të dyja opsionet janë të mundshme dhe varen nga konteksti kombëtar. Sidoqoftë, është e rëndësishme që raportet dhe rekomandimet të diskutohen në parlament, në mënyrë që ai të marrë pjesë në monitorim dhe të mund të miratojë masa kur është e nevojshme. Rekomandohet që OJQ-të të përfshihen në diskutimet parlamentare mbi rekomandimet e Raporterit.

Nuk ka një model ‘më të mirë’: Së fundmi, të katër Raporterët theksojnë se nuk ekziston një model ‘më i mirë’ se të tjerët. Kushtet e përmendura mund të veprojnë si udhëzime bazuar në përvojën e tyre, por çdo vend është i ndryshëm dhe duhet të zgjedhë modelin që i përshtatet më mirë kontekstit të vet kombëtar.

Kompetenca shtesë

Përveç detyrave të monitorimit dhe vlerësimit, mandati i Raporterit Finlandez dhe Belg u lejon atyre të ndërhyjnë në raste individuale. Të dy e konsiderojnë këtë si një pjesë të rëndësishme të mandatit të tyre.

Raporteri finlandez mund të ofrojë ndihmë juridike për viktimat dhe në raste të jashtëzakonshme të ndihmojë viktimën në gjykatë. Kjo përfshin të drejtën për të lëshuar mendime ekspertësh për raste specifike individuale sipas kërkesës. Raporteri mund të japë këshilla ligjore për viktimën, palët që e ndihmojnë atë dhe autoritetet. Ai gjithashtu ka të drejtë të ndërhyjë në raste individuale, për shembull nëse viktimës i refuzohet ndihma që ka të drejtë ta përfitojë. Ai mund të adresojë me iniciativën e tij çdo mangësi në hetim ose trajtimin e viktimës. Ka ende diskutim nëse duhet zgjeruar mandati i Raporterit Kombëtar për të shqyrtuar ankesa individuale.

Raporteri Belg / Myria është i autorizuar të fillojë veprime ligjore dhe të veprojë si palë civile në emër të viktimës ose në emrin e vet. Ai gjithashtu mund të ndërhyjë në raste ankesash ose raste në vazhdim me interes strategjik, në të cilat shkelen të drejtat themelore. Kjo bën të mundur nxjerrjen e praktikës gjyqësore, por gjithashtu i lejon atij të marrë njohuri të thelluara se si trajtohet një çështje, si dhe të ndajë njohuri me gjyqësorin, organin e akuzës dhe avokatët.

Një model që duhet ndjekur për format e tjera të dhunës?

Një pyetje interesante, e paraqitur nga Raporteri Finlandez dhe Holandez, është nëse modeli i një Raporterit Kombëtar i zhvilluar në kuadrin e trafikimit njerëzor, do të ishte gjithashtu i dobishëm në fushën e dhunës gjinore në përgjithësi. Në Holandë, mandati i Raporterit Kombëtar tashmë është zgjeruar për të përfshirë dhunën seksuale ndaj fëmijëve. Në Finlandë, krijimi i një Raporteri të veçantë për dhunën ndaj grave ishte një nga rekomandimet e Raporterit për GRETA, Komitetin mbikëqyrës të Konventës së KE për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje.

Bibliografia

Të përgjithshme

Këshilli i Bashkimit Evropian, Konkluzionet e Këshillit mbi krijimin e një Rrjeti informal të Raporterëve Kombëtarë të BE-së ose Mekanizmave ekuivalentë të Trafikimit të Qenieve Njerëzore; Takimi i 2946 i Këshillit të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme, Luksemburg, 4 qershor 2009. Shih: https://ec.europa.eu/anti-trafficking/eu-policy/councilconclusions-establishing-informal-eu-network-national-rapporteurs_en

Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Prillit 2011 mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij. Shih: <https://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2011:101:0001:0011:EN:PDF>

Faqja web e Komisionit 'Together Against Trafficking in Human Beings': https://ec.europa.eu/anti-trafficking/nationalrapporteurs-andor-equivalent-mechanisms_en

Rrjeti Evropian i Migracionit (EMN). Pyetje Ad-Hoc për zbatimin e Nenit 19 të Direktivës 2011/36/BE mbi vendosjen e rolit të pavarur të "Raporterit Kombëtar ose mekanizmit ekuivalent", kërkuar nga SI EMN NCP më 16 shtator 2014. Përmbledhja e prodhuar më 11 nëntor 2014. Përgjigjet nga Austria, Belgjika, Bullgaria, Qipro, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Republika Sllovake, Sllovenia, Spanja, Suedia, Mbretëria e Bashkuar dhe Norvegjia (21 gjithsej). Shih: http://www.emn.fi/files/1078/Compilation_SI_NCP_AHO_on_implementation_Art_19_Dir_201136EU_Open.pdf

Deklarata Ministrore e Hagës mbi udhëzimet evropiane për masa efektive për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e grave për qëllime të shfrytëzimit seksual. Shih: https://lastrada.org.ua/ucp_mod_catalogue_download_153.html

<http://www.ft.dk/samling/20091/almdel/SOU/bilag/391/894670.pdf>; OSCE (2008). 'Efforts to combat trafficking in human beings in the OSCE area: co-ordination and reporting mechanisms 2008' - Raporti Vjetor i Përfaqësuesit Special dhe Koordinatorit të OSBE-së për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore prezantuar në Takimin e Këshillit të Përhershëm, 13 nëntor 2008. <https://www.osce.org/cthb/36159?download=true>.

SHTETET

Belgjika

Uebfaqja Myria: <http://www.myria.be/en>;

Myria, Raporti Vjetor 2017 trafikimi dhe kontrabanda e qenieve njerëzore. Bruksel: Myria 2018. Shih: <http://www.myria.be/en/publications/2017-annual-report-trafficking-and-smuggling-of-human-beingsonline>.

Artikuj media: DW 11 maj 2017, Tetë princesha arabe dalin në gjyq në Belgjikë. <https://www.dw.com/en/eight-arab-princesses-go-on-trial-in-belgium/a-38796246>; BBC, 23 qershor 2017, princeshat e Emirateve të Bashkuara Arabe fajtojnë për abuzimin e shërbëtorëve në Belgjikë. Shih: <https://www.bbc.com/news/world-europe40380071>;



Myria, Dossier of Emirati Princesses. Trafficking in human beings should not go unpunished, Qershor 2017. Shih: <http://www.myria.be/en/publications/dossier-of-emirati-princesses-trafficking-in-human-beings-should-not-go-unpunished>.

Finlanda

Raporteri Kombëtar kundër Trafikimit të QNJ, Raport 2010: *Trafficking in human beings, phenomena related to it, and implementation of the rights of human trafficking victims in Finland*, Helsinki 2010.

Raporteri Kombëtar kundër Trafikimit të QNJ, Raport 2014: Assessment of the current state of action against human trafficking and of the fulfilment in criminal proceedings of the rights of victims of human trafficking subjected to sexual exploitation Ombudsman for Minorities, Grano: Ombudsman for Minorities 2014. https://www.syrjinta.fi/documents/10181/10850/Ihmiskaupparaportti_2014_ENG_WEB.pdf/cfb3d241-ec2d-4ded-82a0-435db3ec032a

Avokati i Popullit kundër Diskriminimit: The report of the non-discrimination ombudsman to the parliament 2018. Helsinki: 2018. https://www.syrjinta.fi/documents/14490/0/OIKEA_Eduskuntakertomus_englanti/3e49a37f-e7f8-4ba5-85b4-5a6c75e9cc22

Franca

Uebfaqja e Commission Nationale Consultative des Droits de l'Homme: <http://www.cncdh.fr/fr/publications/evaluation-implementation-national-action-plan-against-trafficking-human-beings-2014>; http://www.cncdh.fr/sites/default/files/17.07.06_evaluation_du_plan_teh_en.pdf

Greqia

Uebfaqja e Ministrisë së Punëve të Jashtme: <https://www.mfa.gr/en/foreign-policy/global-issues/humantrafficking.html>

Luksemburgu

Uebfaqja e Commission Nationale Consultative des Droits de l'Homme: <https://ccdh.public.lu/fr.html>; <https://ccdh.public.lu/fr/actualites/2017/03/rapport-traite.html>

Holanda

Uebfaqja e Raportit Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Dhunës Seksuale ndaj Fëmijëve <https://www.nationaalrapporteur.nl/>;

Dhoma e Ulët e Parlamentit: TK 26 206, nr. 15, Emancipation Policy 1999, Letra e Ministrit të Drejtësisë, 29 Qershor 1999

Raporteri Kombëtar kundër Trafikimit: Trafficking in Human Beings. 10 years of independent monitoring, The Hague: BNRM 2010. https://www.nationaalrapporteur.nl/binaries/8e-rapportagenrm-eng-web-tcm64-310472_tcm23-34822.pdf.

Raporteri Kombëtar kundër Trafikimit: Case law on trafficking in human beings 2009-2012 An analysis, The Hague: BNRM 2012. https://www.nationaalrapporteur.nl/binaries/nationalrapporteur-on-trafficking-in-human-beings-and-sexual-violence-against-children.case-law-on-trafficking-2009-2012-interactive-def_tcm23-34764.pdf

Raporteri Kombëtar kundër Trafikimit: Fjala e mbajtur në 'Monitoring Mechanisms in the Fight against Human Trafficking. An international conference on the exchange of best practices and the

strengthening of networks' 14 & 15 Tetor 2010, Hagë, Holandë. <https://www.nationaalrapporteur.nl/Publicaties/Toespraken/Human%20Trafficking%20Conference.aspx>

Portugalia

Uebfaqja e Komisionit për Shtetësinë dhe Barazinë Gjinore: <https://www.cig.gov.pt/planos-nacionaisareas/trafico-de-seres-humanos/>;

Uebfaqja e Observatorit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore: <http://www.otsh.mai.gov.pt/en/Pages/default.aspx>.

Sllovenia

Uebfaqja e Qeverisë së Republikës së Sllovenisë: http://www.vlada.si/en/projects/combating_trafficking_in_human_beings/national_coordinator_for_combatting_trafficking_in_human_beings/

Spanja

GRETA 2018 (7), Report concerning the implementation of the Council of Europe Convention on Action against Trafficking in Human Beings by Spain, second evaluation round. <https://www.coe.int/en/web/antihuman-trafficking/-/greta-publishes-second-report-on-spain>.

Suedia

Përmbledhje e paraqitjes verbale në Zyrën e Këshillit Nordik të Ministrave në Estoni nga Raporteri Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore, nga Kajsa Wahlberg, Autoriteti i Policisë, Suedi, në Tallin, Estoni, 10-11 nëntor 2016.